

**HALIL RAMA
SAKIP CAMI**

**KOMPOZITORI MUHARREM XHEDIKU
(1917-1959)**

**HALIL RAMA
SAKIP CAMI**

MUHARREM XHEDIKU

Kompozitori i tangos shqiptare

Autorë: Halil Rama
Sakip Cami

Redaktor: Nexhat Agolli

Recensent: Teodor Laço
Zhani Ciko

Konsulent : Edmond Zhulali

Sistemoi në pentagram: Xhelil Ymeri

Ndihmuan me materialet dhe fotot: Dr. Emin Xhediku
Afërdita Xhediku

“Shpesh këngët e bukura , të kompozuar me frymëzim dhe ndjenjë të hollë poetike, që kanë transmetuar idealet e larta të popullit dhe punën e gjallë të tij, traditat luftarake e atdhetare të tij, populli i ka bërë të vetat duke shkruar autorësinë e tij dhe duke i shëndrruar në këngë popullore. Kjo ka ndodhur edhe me krijimet e kompozitorit Muharrem Xhediku dhe ky është një fat dhe nder për të.”

**Çesk Zadeja
Artist i Popullit**

**(Nga fjala në simpoziumin shkencor
në Zall Dardhë të Dibrës
me 26 qershor 1982, me rastin e 65 vjetorit të lindjes së Muharrem
Xhedikut)**

**Përse u harrua dhe u mohua për 50 vjet me rradhë
kompozitori Muharrem Xhediku ?**

Kompozitori Muharrem Xhediku është një kompozitor që i përket gjeneratës së artistëve të viteve 40-60, por ai është pak i njohur, për shkak të vdekjes së tij të parakohëshme dhe për shkak të heshtjes që u mbajt ndaj figurës së tij nga qarqet kulturore të kohës.

Zall Dardha, vendlindja e kompozitorit dhe burimi i energjive krijuese të tij

Dardha është një vendbanim i lashtë. Në defterin turk të vitit 1467 Dardha figuron me emrin Darda dhe me 16 shtëpi. Megjithatë egziston version i prejardhjes shqiptare duke u nisur nga emri i frutit dardhë. Thonë që burrat e

këtij fshati mblidheshin nën hijen e një dardhe dhe merrnin vendime të rëndësishme për luftë dhe për punë të mëdha.

Shtëpia e parë në Dardhë ka qenë ajo e Laje nga ka prejardhjen fisi i Xhedikëve. Dardha është një nga nandë malet e Dibrës. Pra është një mal historik që përbëhet nga shtatë male gjeografikë, nga Maja e Madhe, Xhaxhishta, Suka, Shkaurani, Tajani, Tartaj dhe Qeliza.

Lagja Laje në Nezhë

Në Nezhë banojnë katër fise: Çajkëri, Çera, Kaca dhe Xhediku. Këto katër fise përbëjnë lagjen Laje. Xhediku është fisi më i ri nga këto fise në Laje sepse ka ardhur nga Rrafshi i Dugagjinit. Muharrem Xhediku lindi në fshatin Nezhë të komunës Zalldardhë në Dibër më 15 maj 1917. Ai u lind në një familje të mesme fshatare të krahinës. Familja dhe fisi i tij ishte i njohur për trimëri, për këtë shkak Xhedikët respektoheshin në krahinë. Në të gjithë Dardhën shkëlqente lagja Laje që njihej nga nami i mirë i Xhedikëve. E gjithë lagja Laje në Nezhë ishte e mirë por Xhedikët, siç thotë një shprehje popullore “hanin bukë veç”. Nahija e xhedikëve kufizohet nga lindja me Drinin e Zi, nga jugu me fshatin Mustafaj, nga perëndimi me Gurin e Nuses dhe me Kodrën e Çakrit, dhe nga veriu me përroin e Çerës dhe përroin e brrakës. Kjo nahije është e mbushur me pemë e gjelbërim që shtrihen buzë Drinit dhe shoqërohet nga këngët e pandalëshme të bilbilave. Menjëfjalë është një bukuri e rrallë natyrore. Në kodrën e Vilës dhe në buzë të malit të Suko gjenden arat e Xhedikut.

Qëndresa heroike e kësaj zone dhe këtij fshati kundër pushtuesve turq, serbë etj evokohet edhe në karakterin epik të këngëve popullore të zonës së Zall Dardhës.

Po citojmë një fragment nga kënga e kënduar nga Qerim Sula me tekst të Naim Plakut, këngë që për nga mesazhi dhe eposi që transmeton merr karakter mbarëkombëtar:

“Lëshon Korabi gurë e shkrep
Po këndon Drini kangët e veta
Miku i shpisë e la konakun
Dhandrri i ri hoqi dullakun
Plaka në votër e theu furkën
Gratë në llogore e poqën bukën
Fëmija i djepit e mori pushkën...”

Xhedikët, një fis me tradita të lashta atdhetare

Sipas kujtimeve të Dr. Emin Xhedikut, kushuriri i kompozitorit Muharrem Xhediku, xhedikët janë një fis me tradita shumë të lashta. Ata e kanë origjinën nga qyteti i Pejës së Kosovës dhe datojnë që para vitit 1430. Në vitin 1420 në Rrafshin e Dugagjinit u bë luftë e përgjakëshme në mes të ushtrisë osmane dhe popullit të Rrafshit të Dugagjinit. Forcat osmane për të nënshtruar kryengritësit kapën rob dy udhëheqësit e kësaj kryengritjeje, dy vëllezërit Xhet

dhe Dik Kreshniku. Por vëllezërit Xhet dhe Dik Kreshniku u bënë thirrje bashkëluftëtarëve të tyre që të mos ndalnin luftën. Atëhere osmanët vendosën që ti internonin këtë dy vëllezër rebelë në Anadoll. Në malin e Nezhës së Lurës dhe në Qafë Tujanin e Dardhës forcat osmane që shoqëronin vëllezërit Xhet dhe Dik Kreshniku ranë në pritë luftë nga dibranët, kryesisht dernjanë. Në këto luftime të përgjakëshme deri trup me trup u vranë shumë njerëz, edhe pleq dhe fëmijë. Në këtë betejë vëllezërit Kreshniku u shkëputën nga ushtria turke dhe u bashkuan me popullin e Dardhës dhe luftuan si luanë. Mbas betejës atyre ju bë ftesë që të bëheshin banorë të Dardhës. Ata pranuan dhe ndërjuan shtëpitë në buzë të malit të Shkauranit. Edhe sot ky vend quhet ara e Xhedikut. Në Rrafshin e Dugagjinit turqit nuk lanë asnjë far e fis të Xhet e të Dik Kreshnikut, por i shuajti plotësisht.

Në Dardhë ata krijuan shtëpi dhe familje. Xheta vdiq, ndërsa Diku u bë me një djalë që ja la emrin Xhedik, bashkimin e emrave Xhet dhe Dik.

Xhediku, djali i Xhetës vdiq i ri duke lënë dy djem Kreshnikun dhe Bushin, të cilët morën për mbiemër emrin e gjyshit Xhediku.

Për punë ngatërresash me fiset e tjera shpërngulen në Sohodoll, pranë fushës së Kastriotit ku ngritën shtëpitë dhe filluan jetën normale. Meqenëse ndiheshin të fyer nga shpërngulja e detyruar nga Nezha, 15 xhedikë të armatosur kthehen përsëri në Nezhë dhe vendosen përfundimisht atje. Kështu fisi u nda në dy pjesë në Nezhë dhe në Sohodoll, por janë vëllezër dhe nuk marrin e japin brenda fisit.

Por edhe këtu xhedikët nuk e ndalën luftën kundër osmanllinjve. Kreshnik dhe Bush Xhediku me fëmijët e tyre, pasi bënë thirrje dhe gjetën përkrahje edhe nga Çajkëri, Kaca dhe Çera i ranë shtabit ottoman që ndodhej në zonën e tyre. Bush Xhediku dhe Bush Çajkëri luftuan heroikisht dhe u vranë. Ata i varrosën në një varr si dy vëllezër.

Kështu Xhedikët me Çakëret, Kacet dhe Çeret u bënë vëllezër bese.

Kreshnik Xhediku la Sokolin. Sokoli la katër djem, Demirin, Saliun, Sulën dhe Kurtin, të cilët e vazhduan luftën kundër turqve. Porta e lartë e Stambollit internoi në Turqi Imer Xhedikun, i cili vdiq atje.

Ka edhe disa të dhëna të tjera që flasin për xhedikët e Pejës. Xhediku i parë qe komandanti i parë i kalasë më të madhe të qytetit të Pejës. Po kështu edhe xhediku i dytë dhe i tretë. Kjo pronësi apo e drejtë komandimi njihej me dekret nga Porta e Lartë e Stambollit.

Xhedikut të Pejës, pra komandantit të qytetit të Pejës që nuk po i bindej Portës së lartë për ti dhënë taksa dhe ushtarë, Perandoria Osmane me urdhër të Sulltan Mehmetit të dytë i mori peng djalin e madh, Ahmetin.

Ahmeti u bë jeniçer dhe bëri shkollën e jeniçerëve në Turqi, ku u shqua për rezultate të larta. Në fillim u bë oficer i thjeshtë, por pastaj shkallë pas shkalle, gradë pas grade, në vitin 1472 u bë general (pasha). Si pasha të zotin Ahmet pashë Xhedikun e dërgonin në betejat më të vështira jashtë Turqisë, atje ku kishte fortesa më të mëdha. Në vitin 1474 për merita lufte merr titullin Vezir dhe në vitin 1475 merr titullin Vezir i Madh, kryegjeneral i ushtrisë osmane.

Por Ahmet Pashë Xhediku nuk ju bind Sulltanit për pushtime në Shqipëri dhe konkretisht në Shkodër, prandaj ai organizoi vrasjen e tij më 1487 si dhe të

dhëndrrit e të vjehrrit të tij. Në këto kushte vëllai i Ahmetit, Ismaili shpëngulet nga Peja dhe vendoset në Dardhë të Dibrës, në katundin Tarte, në vendin e quajtur Shkaurra , ku edhe sot gjendet një arë me emrin “ara e xhedikut”.

Këtu Xhediku ndërtoi kullat dhe ringriti pasurinë. Këtu u priu të gjithë fiseve për të mos ju nënshtruar pushtimit osman deri në ndërtimin në Lashkizë të Kalasë së Zhugjrit.

Pema gjenealogjike e xhedikëve të Nezhës që nga viti 1900, që nga Emin Xhediku i vjetër është si më poshtë: Emin Xhediku la katër djem Demirin, Saliun, Sulën dhe Selën. Demiri, gjyshi i Muharremit, la Hajredinin, babain e Muharremit, Eminin , Demën dhe Shaqirin. Emini dhe Dema nuk lanë trashëgimtarë. Hajredini la dy djem Muharremin dhe Zenelin. Shaqiri, xhaxhai i Muharremit la Rizain. Rizai la Dr. Emin Xhedikun që ka shërbyer si mjek me emër në Tiranë, Demirin, Miftarin, Sabriun dhe Shaqirin.

Muharremi nuk la fëmijë. Zeneli la Hajredinin dhe Besnikun.

Gjyshi i Muharremit, Demir Xhediku ishte i njohur për burrëri e trimëri. Por në historinë e lavdishme të Dardhës janë futur edhe xhedikë të tjerë si Sufë Xhediku, Shaqir Xhediku, Xheladin Xhediku, Vesel Xhediku etj. Vesel Xhediku ishte një nga të 15 përfaqësuesit e parlamentit të Dardhës, ose nga të pesëmbëdhjetët e Dheut siç njihej në atë kohë.

Kanga popullore thotë:

”Him Xhediku si drague

Dymbëdhjetë prit at i ka kalue

Në Kastriot kur asht afrue

Britëm të madhe trimi ka lshue:

“Lala Sufë të lasha mallkue

Nji sahat të më kisha përgjue

Derën e madhe kisha me ta lirue

Se kam Hasanin ma trim se mua

.....

Babai i Muharremit, Hajredini, vdiq në moshë të re në përpjekje me pushtuesit serbë duke e lënë vetëm dy vjeç. Por nëna e mëkoi Muharremin jo vetëm me qumësht, por edhe me trimëri dhe me talent.

Zall Dardha, vendi ku fëmijët lindin duke kënduar

Zall Dardha quhet djepi i artistëve. Sivjet Grupi Artistik Folklorik i kësaj zone mbush 60 vjetorin e tij. Mund tju duket e çuditëshme, madje e pabesueshme, që ndryshe nga e gjithë bota, ku fëmijët lindin duke qarë, në Zall Dardhë të Dibrës fëmijët lindin duke “kënduar”, thotë Shaqir Çerpja një artist popullor nga Zall Dardha. S’ka si të shpjegohet ndryshe fakti që në këtë vend ka aq shumë artistë në raport me numrin e popullsisë. Ndodh kështu jo vetëm për efektet e trashëgimisë historike qëndrestare ndaj armiqve, por edhe për efektet e trashëgimisë kulturore folklorike.

Në Zall Dardhë nuk ka shtëpi që nuk ka vegël muzikore popullore, fyell, çifteli etj. Në Zall Dardhë lindën dhe u rritën njerëz që lanë gjurmë në muzikën etnike

shqiptare si Muharrem Xhediku, Hazis Ndreu, Lirie Rasha, Skënder Cala, Qerim Sula, Caje Poleshi, Xhelal Çerpja, Sherif Dervishi etj. Janë me dhjetra muzikantët, instrumentistët, valltarët, këngëtarët popullorë nga Zall Dardha që me kontributin e tij jo vetëm kanë dhënë shfaqje në Zall Dardhë e Dibër por edhe në mbarë Shqipërinë, bile në skenat më prestigjioze të Amerikës dhe të Europës.

Pikërisht në këtë vend, djep të artistëve lindi dhe u rrit, u mëkua kompozitori Muharrem Xhediku. Nëna e tij e rriti duke i kënduar mbi krye ninulla trimërie, ninulla dashurie, ninulla bukurie, por mbi të gjitha e rriti duke kënduar, ndonëse pas vdekjes së të shoqit këto ninulla u bënë tragjike, por edhe frymëzimi i ardhshëm i kompozitorit Xhediku, që pa dyshim kishte një talent të lindur.

Shtëpia ku lindi kompozitori i ardhshëm

Si në të gjitha shtëpitë e xhedikëve, edhe në shtëpinë e Demir Xhedikut, të jatit të Hajredinit, gjyshit të Muharremit, në mur varej çiftelia, në sepete gjendeshin lahuta, fyelli dhe vegla të tjera muzikore. Ishte e pamundur që djemtë e xhedikëve të mos dinin të këndonin me çifteli apo të mos hidhnin vallen e rëndë të burrave, ëq varzat të mos këndonin e kërcenin si zana. Pra Muharremi u rrit jo vetëm në një mjedis patriotic, por edhe në një mjedis kulturor, folklorik të paparë në ndonjë vend apo krahinë tjetër. Ndoshta ninullat e bukura dibranë të nënës së tij, Sudes i mbetën në mendje dhe ju bënë motivet e muzikbërjes së tij.

Shpërngulja e detyruar për në Tiranë

Babai i tij Hajredini u vra nga serbët në vitin 1919. Kështu Muharremi mbeti jetim në moshën 2 vjeçare. Në këto kushte e ëma u detyrua që së bashku me katër fëmijët e saj në vitin 1922 të emigronte në Tiranë, por pa asnjë bazë ekonomike, pa strehim e punë. Sapo arritën në Tiranë, një i njohur i vëllait të Sudes, Nel Alisë, i fali një barakë të vjetër pa dyer e pa dritare, të mbuluar me teneqe. Në këto kushte vdesin dy fëmijë. Vëllai më i madh i Muharremit vdiq nga puna e rëndë e hyzmeqarit, megjithëse fëmijë si dhe nga jeta e keqe e nga skamja. Mbeti vetëm Muharremi dhe Zeneli. Muharremi vinte shëndetlig dhe i vuajtur. E jëma Sudja punonte në stehën vorfnore si rrobalarëse. Nënë Sudja ishte një grua e urtë si të gjitha gratë dibrane të asaj kohe, por në mënyrë të veçantë Sudja bënte dallim sepse vinte edhe nga një derë e mirë, nga dera e Aliajve në Dibrën e Poshtme, fis nga kanë dalë figura të mëdha patriotike si Salë Demiri, Selman Alia etj.

Mësimet e para dhe varfëria e tejskajshme

Muharremi shkollën fillore e mbaroi pranë strehës vorfnore në Tiranë. Këtu ai përveç bukës së përditëshme siguroi edhe mundësi argëtimi dhe muzike për vehte dhe për shokët sepse talenti i tij doli menjëherë në pah. Në kryeqytetin e atyre viteve familja e tij bëri një jetë të mundimshme, dhe si pasojë Muharremi u rrit në varfëri.

Kërkoi të shkonte për studime, sepse kishte talent dhe të dhëna, dëshirë dhe pasion, por nuk mundi të siguronte bursë studimi se edhe në atë kohë bursat jepeshin me mik, vetëm për të pasurit dhe për njerëzit që përkrahnin regjimin e Zogut.

Në vitin 1933 Muharremi arriti të siguronte një punë në një ndërmarrje italiane, por edhe aty pati shkurtime dhe ai u shkurtua i pari si i ri që ishte. Kjo e bëri atë që të ishte i pakënaqur ndaj qeverisë zogiste. Ai kritikonte dhe stigmatizonte regjimin e Ahmet Zogut që e kish pllakosur vendin në varfëri dhe për këtë, ky regjim e burgosi atë disa herë. Herën e fundit arriti të dalë nga burgu duke e thyer atë. Për këtë në vitin 1937 ai u shpall nga mbretëria si element i rrezikshëm dhe u burgos.

Arratisja nga burgu zogist

Edhe në burg ai i binte çiftelisë dhe këndonte këngët e bukura dibrane dhe të veriut. Një gardian nga Mati i pëlqente shumë këngët e tij. Në heshtje dhe fshehtësi ai i afrohet dhe i thotë:” Mor djalë ti paske zanat fort të bukur, e qitke lek nëpër dasma, prandaj sillu mirë, dil prej burgu dhe merru me muzikë.”

Po kështu edhe shumë gardianë të tjerë gjatë turnit të tyre afroheshin pranë dritarës së qelisë së Muharremit dhe dëgjonin muzikë popullore.

Por ç’e do se në bazë të akt akuzës Muharremi do të dënohej 20 vjet burg, prandaj rruga e vetme e shpëtimit ishte arratisja nga burgu dhe largimi për në Itali për të ndjekur ndonjë shkollë muzike , të cilën Muharremi e kishte ëndërr. Një natë para se të dilte në gjyq një shok i dërgoi një pako me ushqime. Në këtë pako ishte një ibrik me kos ku në fund ishte një sharrë hekuri dhe një kastravec ku në mes ishte një limë hekuri.

Shoku e porositi:” Kujdes e kosi është i hollë, por merr nga fundi, edhe kastravec i është pak i vjetër, por ti haji zemrën. Po nuk e konsumove ushqimin sonte, nesër nuk do të sjellim më gjë.” Muharremi e kuptoi në çast se porosia e tij kishte ardhur. Gardianët nuk e kontrolluan ushqimin e këngëtarit të tyre të preferuar.

Muharremi kërkon të shkojë në banjë nga mesi i natës dhe atje mbyllet brenda derisa arrin që të sharrojë hekurat e dritareve të banjës dhe të arratiset nga kjo banjë e pavëzhguar nga rojet.

Jepet alarmi në burg. Rrethohet edhe pjesa në periferi të burgut. Muharremi ndodhej pikërisht tek Bregu i Lumit. Për tu shpëtuar të shtënave të rojeve dhe ndjekjes së tyre hidhet në lumë dhe bën sikur mbytet. Në fakt gjen një tub llastiku të cilën arrin ta mbajë në gojë dhe ta nxjerrë mbi ujë. Kështu ai arriti të mbijetojë. Ndërsa xhandarët dhanë lajmin se Muharremi ishte mbytur dhe dërguan lajmin në shtëpi. Nënë Sudja e mjerë në barakën e vogël shpalli vdekjen e djalit dhe njoftoi të afërmit në Dibër. Milicët kishin hapur lajmin se

kafhsët eja kishin coptuar kufomën dhe nëna e vajtoi djalin për së gjalli pa kufomë.

Myslimani që u konvertua në prift Studimet në kolegjin jezuit të Shkodrës

Muharremi arriti të shpëtojë dhe të mbijetojë pas rënies në lumë. Ai arriti të vishet si fshatar, por vendosi të mos kthehej më në shtëpi, por të udhëtonte drejt Shkodrës. Udhëtimi zgjati 5 ditë, rrugë e pa rrugë. Kudo që kaloi ai ghasi në bujarinë e njerëzve, të fshatarëve lezhjanë dhe të shkodranëve.

Pasi punon për një farë kohe si karrocier për shpërndarjen e qymyrit nëpër shtëpitë e qytetit të Shkodrës, me emrin Martin Mirashi dhe me dokumenta të rreme të një shoku, futet në kolegjin jezuit të Shkodrës. Mundësia që arriti të futej në këtë kolegji ishte se fare rastësisht ai shpëton jetën e nipit të drejtorit të Kolegjit, i cili ra nga një pemë. Por emri Martin Muharremi ju fiksua si një emër i dytë, si një emër i dashur. Edhe sot një nga nipat e Muharremi jo rastësisht mban emrin Martin, që është një nga amanetet e tij.

Studimet teologjike në Itali

Pas tre vjetësh, kolegjin e mbaroi shkëlqyeshëm dhe u diplomua si prift. Drejtori i këtij kolegji, që e kishte shumë për zemër Muharremin (Martinin) e ndihmoi të shkonte për studime teologjike në Itali, bursë nëpërmjet Vatikanit. Ishte ende i ri, kur emigroi në Itali, ku u gjend nën përkujdesjen e një prifti i cili e bëri bir në shpirt. Edhe në kolegjin e lartë të jezuitëve të qytetit të Laningos u dallua për zell në mësim dhe zgjuarsia. Por në vitin e fundit të kolegjit ai shpалos të vërtetën e fesë së tij dhe të bindjeve të tij që tani nuk ishin as muslimane dhe as katolike, por ateiste. Për këtë atë e burgosin në Vatikan. Me ndihmën e Luçias, vajzën e një pedagogu të jashtëm të tij, por që nuk jepte lëndë fetare, por shkencore, arriti të arratiset nga ky burg duke u veshur si murgeshë.

Studimet në Konservatorin e Bolonjës

Më pas në Itali filloi jetën e vështirë të emigrantit ekonomik. Pa punë, pa përkrahje, i vetmuar dhe pa shpresë shkon në Siçili dhe fillon punë si kamarier. Punoi tre muaj dhe mori vlerësimin e pronarit të lokalit. Pronari i lokalit kishte një mik në Bolonja, që kishte një lokal me muzikë dhe që kishte nevojë për një kitarist që dinte gjuhë të gjuaja. Muharremi me emrin Italian

Mario shkon në Bolonja dhe konkuron për këtë vend pune. Fitoi jo vetëm punën si kamarier, por edhe si kryekamarier. Pronari i këtij lokali ishte njëkohësisht edhe administrator i një konservatori muzike. Muharremi (Mario) ju lut pronarit që të studionte për muzikë në këtë konservator jashtë orarit të punës dhe në fund tu nënshtrohet provimeve. Kështu ndodhi Xhediku mori diplomën e konservatorit dhe mbi të gjitha ra në sy për talentin e tij si kitarist. Duke qenë edhe në punë arriti të vazhdojë studimet në konservatorin e Bolonjës, sepse kishte talent në fushën e muzikës dhe të kompozicionit. Atje mori edukimin e parë muzikor, por duke qenë se ai kishte lindur i talentuar nuk e pati të vështirë ti mbaronte studimet e konservatorit me rezultate të larta.

Kthimi në Shqipëri

Me largimin e Zogut, Muharremi vendosi të kthehej në Shqipëri. Ishte shpallur amnisti për të dënuarit e regjimit të Zogut. Ishte koha kur Shqipëria vuante nën thundrën u pushtuesit Italian dhe tashmë Muharremi kishte shtatë vjet që nuk e kishte parë familjen e cila e konsideronte të zhdukur. Muharremi vendos të kthehet në atdhe dhe të japë kontributin e tij. Kishte bërë edhe lekë sepse kishte punuar si kamarier dhe si kitarist në shumë lokale të Italisë.

Pronarët e fundit italianë i kishin premtuar edhe për një trashëgimi të vogël. Ata organizojnë edhe një mbrëmje ndarje për Muharremin, ose Marion ashtu sikurse njihej ai gjatë qëndrimit në Itali. Pas darkës pak metra larg lokalit dy vetë e godasin dhe e mbërthejnë për ti rrëmbyer paratë dhe dokumentat e trashëgimisë. E raportojnë se është shqiptar dhe se fshihet me emër të rremë. Të nesërmen gazetat botojnë në kronikën e zezë për një shqiptar që kishte mashtruar dhe ishte fshehur nën një emër Italian. Kështu Muharremi humbi edhe paratë, edhe atë trashëgimi të vogël të premtuar me akt noterial. Çdo gjë duhet tja fillonte përsëri nga e para. Merr rrugën për tu kthyer në Shqipëri dhe niset drejt portit të Barit. Futet në një vapor mallrash që kishte ngarkuar qymyr dhe niset për në Shqipëri.

Me të arritur në Durrës, i pangrënë, i veshur keq dhe i lodhur niset në këmbë drejt Tiranës, drejt shtëpisë, drejt barakës së vjetër ku priste nënë Sudja.

Nënë Sudja e dinte të vdekur, por thellë në zemër ajo besonte se djali ishte gjallë. Kur e kishin vrarë xhandarët, asaj nuk ja kishin sjellë kufomën, nën preteksin se e kishin dëmtuar kafshët. Njëpërmjet natës dhe mjegullës udhëtoi Muharremi drejt shtëpisë së tij. Nënë Sudja kishte shtatë vjet që qëndronte krejt sy e veshë se një ditë apo natë do ta dëgjonte zërin e djalit të saj. Dhe mrekullia ndodhi. Ishte Muharremi që thirrte :”Nënë, hape derën, jam Muharremi.” Nënë Sude nuk e lente qeni të dëgjonte, por zërin e djalit të saj arriti ta dallonte. E pabesueshme, por e vërtetë. Mblodhi vehten. Kishte shtatë vjet që e priste këtë cast. Kishte shtatë vjet që nuk besonte se djali kishte vdekur. Ju hodh në qafë. Pa fjalë, pa lotë, të hutuar, por të mrekulluar.

-Aman, bir, mos u largo më nga nëna. Të kam dritë syri, mor bir. Fotografia që ju shikoni është pikërisht e vitit 1939, e momentit kur Muharremi u kthye nga Italia, pas shtatë vjetësh.

Nga Porto Palermo në Dibër të Madhe.

Shpresat e djaloshit për të gjetur ndonjë punë, për të mbajtur vehten dhe të jëmën ishin të pakta. Vëllai i tij Zeneli, në gjendje të sëmurë mezi mbante fëmijët e tij. Muharremi ishte në kulmin e moshës, 22 vjeç, për punë dhe për të realizuar ëndërrën e tij të kahershme, muzikën. Dëshira për tu bërë muzikant, i qëndronte brenda shpirtit të tij prej artisti. Kërkoj punë dhe gjeti në një ndërmarrje botore si përkthyes, por vetëm për 6 muaj. Hapi vetë një zyrë përkthimi, por nuk e lejuan të punonte as 6 muaj. Gjendja e vështirë ekonomike, papunësia shoqërohej edhe me një hasmëri apo përndjekje nga kleri katolik për dokumentat e rreme që kishte paraqitur dhe për largimin nga shërbimi i fesë katolike.

Në këto kushte largohet nga Tirana për në Dibër të Madhe, ku hap një zyrë përkthimi dhe një dyqan të vogël si cigareshitës. Pas 6 muajsh e merr vesh Halil Alia se Muharremi ishte në Dibër të Madhe dhe shkon ta takojë. Muharremi ishte nipi i Nel Alisë, por Neli me Halilin nuk shkonin mirë. Halili i propozon që të lëmë hasmëritë mënjanë dhe të bashkëpunojnë. Ai i premtoi edhe për grada dhe ofiqe të larta, por Muharremi nuk pranoi. Ai vinte nga Italia dhe e njihnte në thelb fashizimin Italian. Vendimi i Muharremit ishte i prerë: “Unë i shërbej vetëm atdheut tim.” Kam edhe një dëshirë timen personale që të merrem me muzikë. Dhe Halili me kapadaillëk i kishte thënë:” E pra ti nuk qenke xhedik, por ahengxhi.”

Në Dibër të Madhe Muharremi lidhët me shokët që kishte patur në internim, në Porto Palermo. Ata e këshilluan që të shfrytëzonte aftësitë e tij për gjuhë të huaja dhe të futej në një zyrë shtetërore, por Muharremi nuk kishte njeri që të futej garant për të.

Në varr për së gjalli

Një natë, kur po futej në shtëpinë ku banonte, dy njerëz të armatosur e kapin dhe arrestojnë. Të nesërmen merret në pyetje në kuesturën fashiste. E pyetin se kë njeh në Dibër nga personalitetet ushtarake dhe civile vendore. Muharremi përgjigjet se njeh Halil Alinë. Por Halil Alia, kur njoftohet nga kuestura fashiste e mohon Muharremin duke thënë se nuk e njeh, se nuk ka të bëjë me të, se ky person nuk është dibran, por është nga Tirana dhe se autoritetet duhet të mos e lëshojnë pa e verifikuar mirë. Qëndroi 35 ditë në arrest, me tortura dhe ankth dhe ditën e tridhjetë e gjashtë e fusin në një makinë të mbyllur, të lidhur këmbë e duar dhe e ndalojnë diku andej buzë Korabit. Ishte buzë përroi, greminë. Më zgjidhën sytë dhe më thanë:”Tani bëje varrin vetë!” Kështu na kanë urdhëruar. Ti do të varrosesh i gjallë.”

Muharremi punoi me një kazëm dhe një lopatë për shtatë ditë me rradhë me dy ushtarakët e armatosur mbi kokë që herë flisnin shqip dhe herë anglisht. Në

ditën e shtatë arriti ta hapte një gropë të madhe 2 metra të gjatë dhe po aq të thellë. I jepnin ushqim sa për të mbajtur shpirtin gjallë dhe për të punuar, për të mos vdekur nga mosushqyerja dhe puna. Në ditën e tetë i kërkuan përsëri kompromis për bashkëpunim. I dhanë 48 orë kohë për tu menduar. Sigurisht kjo kohë ishte vetëm për tu menduar, pa ushqim, pa cigare, pa asgjë. Pas 48 orësh dy ushtarakët u kthyen dhe e pyetën nëse kishte reflektuar. Muharremi u tha se nuk kishte parë e dëgjuar të torturohej njeriu pa faj dhe pa shkak. Ai firmosi në letër të bardhë se nuk kishte asnjë për të thënë dhe për të bashkëpunuar.

-Paç vehten në qafë, e kërcënuan dy ushtarakët e armatosur.

Dy ushtarakë të tjerë më hypën të lidhur në një makinë të mbyllur dhe u nisëm. Një nga ushtarakët rrinte përpara më shoferin dhe njëri rrinte prapa në karroceri dhe më ruante mua. Rruga ishte shumë e keqe, gropa gropa. Makina tundej shumë dhe ushtaraku që ishte lart në karroceri nuk duroi më, por e ndaloi makinën dhe kërkoi që edhe ai të rrinte përpara. Mbeta vetëm. Në një kthesë Muharremi pa se dera ishte e hapur. Au hap vetë nga presioni i rrugës, apo e harroi oficeri fashist nuk u muar vesh, por Muharremi menjëherë filloi të përpunonte me shpejtësinë mundësinë e hedhjes nga makina. Shtyu derën e makinës me këmbë dhe në një kthesë të padukëshme hidhet. Ra poshtë po thuajse i vdekur, por me vështrimin dhe frikën në se e panë apo jo nga pasqyra, nëse do të ndalet makina apo jo. Makina nuk ndaloi, por eci nëpër atë rrugë të keqe kalldrëmi. Me rrokullisje Muharremi i afrohet një zgavre shkëmbore. Më mirë të vdes këtu se të më pushkatonin fashistët, mendoj Muharremi i rraskapitur dhe i lodhur deri në vdekje.

E kishte kapur gjumi menjëherë dhe vetëm të nesërmen në drekë zgjohet nga një e lehur qeni. Një bari me një tufë me dhi kishte kaluar aty dhe qeni kishte diktuar erën e njeriut gjysmë të vdekur. Bariu me pushkë në dorë afrohet me ndruajtje drejt zgavrës. Muharremi i kishte rënë të fikët nga lodhja, mosushqyerja dhe tmerret që kishte përjetuar. Bariu i kishte hedhur një grusht me ujë të ftohtë dhe Muharremi ishte përmendur. Pasi ishte përmendur i kishte dhënë pak bukë misri nga torba e tij, pak speca, gjizë dhe turshi.

Muharremi pasi e kishte vënë në be dhe besë bariun i kishte treguar për ngjarjen që kishte kaluar dhe për varrin e hapur.

-Dëgjo, i kishte thënë bariu. Ti nuk duhet të lëvizësh prej këtu sepse jo më larg se tek ajo gorica në majë të kodrës janë një skuadër që ruajnë me armë në dorë dhe janë vënë në kërkimim tënd. Makina është larguar, por ata nuk largohen derisa të të gjejnë. Kanë vënë edhe lajmërim në fshat për ty. Bariu i solli përsëri ushqim nga shtëpia dhe e shoqëroi drejt kufirit të Qafë-Thanës. Kështu Muharremi filloi një rrugëtim tjetër të gjatë por këtë herë drejt Kosovës.

Në Kosovë

Pas 25 ditë dhe netë udhëtimi rrugë e pa rrugë nëpër male arriti në Prishtinë tek Ivan Tomasheviqi për të cilin kishte patur një rekomandim nga Alush Zari, me të cilin kishte patur lidhje që në Tiranë. Ivani e pranoi në shtëpi, i ofroi

strehim dhe e ndihmoi të punonte si përkthyes në Dhomën e Trtegetisë. Më vonë Muharremi arrin të futet si nëpunës, protokollist, arshivist në zyrat e pushtetit fashist në Prishtinë. Ai njihte disa gjuhë të huaja dhe kjo e ndihmonte në punën e tij. Megjithatë ai ishte kurdoherë në vëzhgim. Në vitin 1943 një spiun kishte dorzuar një listë për burgosjen e 92 shokëve kosovarë në federalin e Ferizajt. Muharremi njoftoi shokët dhe ata arritën që të shpëtonin. Ai ndiqej në çdo hap nga shkonte dhe nga luante. Këtë e dinte mirë Muharremi, ndaj dhe arriti që spiunin Alush Agai ta qëllonte për ta vrarë, por nuk arriti ta vrasë. Pas këtij atentati shtatë karabinjerë e rrethojnë dhe e kapin dhe në tetor 1943 e burgosin në kampin e Prishtinës.

Në kampin e internimit në Prishtinë

Kampi i internimit në Prishtinë nuk ishte kamp, por burg dhe kaluar burgut. Ai ishte i rrethuar me tela me gjemba. Qëndroi në këtë kamp internimi deri në qershor të vitit 1944, kohë kur arriti të arratiset nga kampi nëpërmjet kanalit të ujërave të zeza të kampit që kishte dalje në qytet. Udhëtoi një muaj rresht nëpër malet dhe fshatrat e Kosovës deri sa arriti në fshatrat e Dibrës.

Dashuria me Jelicën

Jelica. Një emër, një dashuri, një ëndërr, një këngë, një shpresë, një gëzim, një hidhërim, një vuajtje, një femër jo si të gjitha femrat, një vajzë e veçantë që ja ngriti peshë zemrën që në momentin që e pa për herë të parë.

Pikërisht atëhere kur shpresat ishin ndërprerë, u shfaq ajo, Jelica vajza malazeze. Ajo ishte e bija e kryegardianit të burgut. Ajo hynte e dilte në kamp për të takuar të jatit. Ishte vetëm 16 vjeçe dhe babai e kishte dritë të syrit.

Një ditë u takuan rastësisht në oborrin e kampit Jelica, malazezja 16 vjeçare, e bija e komandantit të kampit dhe Muharremi, i burgosuri shqiptar, që nuk pajtohej me asnjë regjim e padrejtësi.

Muharremi, ky muzikant i lindur që prodhonte dashuri me sy, me zemër, me buzë, me këngë, me kitarën që s'e ndante asnjëherë e tërhoqi si një magnet vajzën e bukur si ylli. Shikoni këtë fotografi ku Muharremi ka dalë si partizan bashkë me Jelicën dhe do të bindesh se me me çfarë perrije kishte hasur muzikanti dhe partizanti shqiptar i shkolluar në Konservatorin Italian. Jelica kishte ballë të gjërë, sy të shkruar, trup të hedhur. Ishte një bust i gjallë i përgatitur nga dora e Zotit dhe e skulptorit më të mirë të botës. Jo më pak ishte Muharremi, që mbi të gjitha ishte shumë tërheqës në në kontaktin e parë dhe nuk mund ti bëje ballë tërheqjes ndaj tij.

Kështu ndodhi edhe me Jelicën. Sapo e pa Muharremin, i rrahu fort zemra, kraharori sa nuk doli nga vendi, truri ju bllokua nga dashuria.

Çdo ditë nuk mund të kalonte pa u takuar, pa u parë. Muharremi për këtë vajzë të bukur që më vonë do të bëhej gruaja e tij kompozoi këngën e famshme "Jelica".

Arratisja nga kampi nazist

Për bashkimin e tyre mendoi vajza e bukur malazeze. Ajo përgatiti një plan të shkëlqyer arratisjeje që do ta kishte zili edhe një oficer i përgatitur i shërbimeve secrete. Dy të rinjtë arritën të arratisen nga kampi me ndihmën e Alush Zeqirit, që u tregoi dhe i ndihmoi të kalonin nëpërmjet kanalit të ujërave të zeza të kampit që kishte dalje në qytet. Një kalvar i papërshekruar vuajtjesh edhe në këtë kanal të ngushtë e të qelbur, por nuk kishte gjë që i ndalte dy të rinjtë e dashuruar.

Vetëm një ditë për tu çmallur në shtëpinë ku kishte lindur, në Nezhë.

Sapo ju afruan Dibrës e tërhoqi si magnet vendlindja. Një mall i papërshekruar i pushtoi kraharorin. Kur po i afrohej portës së shtëpisë së vjetër ku kishte lindur, i turret qeni i shtëpisë. Nënë Ahmedija vrapon të ndalojë qenin. Ajo së bashku me Sylbijen po kositnin jonxhën.

-Oj nanë Ahmedija, mos e nga qenin se ai nuk më han mua, se ai nuk e han njeriun e shtëpisë. Dhe me të vërtetë qeni ju lëshua për ta përçfuar dhe jo për ta ngrënë.

Muharremi përqafohet me nënë Ahmedijen. Kishin kohë pa u parë. Ishin përmalluar, aq më tepër që ishte kohë lufte dhe merakuri ishte tepër i madh.

Muharremi puthte çdo qoshe të shtëpisë. Pinte dhallë të ftohtë dhe ndërsa Sylbija gatuante një petë të ngrohtë me miell misri, së bashku me nënë Ahmedijen dolën në qefeze për të parë me sy dhe me dylbi.

Sa i bukur dukej Korabi ! Sa i bukur ishte Drini dhe lugina e tij !

Këtë vend të bekuar do të bëjmë edhe më të begatë i thoshte Muharremi nënë Ahmedijes, tek shikonte pemët e mbjellura me dorën e tij nga i jati Hajredini. Afrohet tek varri i mixhë Shaqirit dhe vendos një kurorë të freskët me lule.

Të nesërmen Muharremi shkon në Sllatinë ku do të formohej Brigada e 18 Sulmuese.

Partizan në Brigadën e 18 Sulmuese

Muharremi së bashku me Jelicën (tashmë bashkëshorten e tij) inkuadrohen në brigadën e 18-të ku shërbeu në sektorin e propagandës dhe në korin partizan. Muharrem Xhediku njësohet me ata kompozitorë partizanë që krijuan këngë, hymne dhe balada për luftën nacionalçlirimtare ashtu si Dhora Leka, Papparisto, Jakova, Avrazi etj. Ndërsa bashkëshortja e tij Jelica dhe një kontribut të madh në mjekimin e të plagosurve të Brigadës.

Muharremi mban medaljen e çlirimit për pjesëmarrje me armë në dorë në rreshtat ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Miço Kallamata, kuadër i Brigadës 18 Sulmuese, shkrimtar, në kujtimet e tij shkruan:

”Muharrem Xhediku ishte një partizan dhe kuadër shembullor i Brigadës. Ai kryente me përpikmëri të gjitha detyrat e ngarkuara, duke luftuar me pushkë, penë dhe kitarë.” Sëmundja e rëndë si pasojë e

vuajtjeve të luftës e shkëputi nga gjiri i artistëve të Shqipërisë në kulmin e jetës dhe të krijimtarisë së tij progressive.

Sëmundja e rëndë

Në dhjetor të vitit 1944 e deri në janar të vitit 1945 sëmuret rëndë nga tuberkulozi dhe ftohja e rëndë maleve, burgjeve e internimeve dhe kurohet në spitalin ushtarak të Tiranës. Pas dalje nga spitali aktivizohet me ansamblin e Ushtrisë ku qëndroi deri në maj të vitit 1946. Nga viti 1946 rimobilizohet dhe shkon me shërbim në Korçë. Përsëri sëmuret dhe detyrohet përfundimisht të largohet nga ushtria për arsye shëndetësore. Për rreth dy vjetësh kurohet në spitalin e Tiranës dhe pas daljes nga spitali fillon si kitarist në orkestrën e Teatrit Popullor, që më vonë kthehet në filarmoninë e Tiranës. I besohet detyra e përgjegjësit të orkestrës së Estradës së Tiranës. Por kudo që punoi shoqërohet me sëmundjen e rëndë të tuberkulozit dhe me punën pasionante si muzikant.

Ndarja me Jelicën

Me kalimin e viteve ftohja që kishte marrë në internim dhe jeta e vështirë që kishte bërë në male, burgje dhe internime bëri që sëmundja ti avanconte dhe ti shfaqeshin shenjat e tuberkulozit. Ndoshta ishte ky shkaku që martesë e tij me Jelicën, që mbeti dhe dashuria e tij e vetme e vërtetë, të merrte fund. Ndarjen me Jelicën e përjetoi në mënyrë dramatike. Por shkaku i vërtetë i ndarjes me Jelicën nuk ishte sëmundja e Muharremit. Jelica ishte një grua e rrallë, e dashuruar marrëzisht me Muharremin, i shërbente si fëmijë, e puthte, e lante, e ndërronte, i rrinte mbi kokë, e shihte në dritë të syrit. Po cili ishte shkaku i vërtetë i ndarjes me Jelicën, me këtë dashuri të lindur për mes plumbave? Shkaku i vërtetë pas hulumtimeve tona dhe sipas të njohurve që jetojnë edhe sot ishin fjalët e liga, opinion i keq i kohës për gratë me kombësi të huaj, presioni që bëhej nga Partia Shtet e asaj kohe dhe sigurimi shtetit që i shikonin femrat e huaja si agjente, si kundërshtarë të regjimit komunist. Në Sanatoriumin e Shtetit në Tiranë ku shërbente Jelica dhe që kurohej të shumtën e kohës Muharremi punonte edhe Dr. Kalvari, një mjek serb, të cilin e akuzuan për mardhënie me Jelicën, gjë që nuk ishte kurrë e vërtetë sepse Jelica dashuronte marrëzisht Muharremin. Edhe pjesëtare të fisit, opinionit, etj filluan të flisnin poshtë e lart për Jelicën e pafajshme. Fjalët e liga e bënë punën e tyre. Ata ranë si bomba mbi trurin dhe zemrën e Muharremit të sëmurë që ndonëse nuk e besoi derisa vdiq se Jelica e kishte tradhëtuar ra dakord që të ndahej me të.

Martesa me Cajen, vajzën nga Shijaku

Megjithatë ai gjen forca ta vazhdonte jetën dhe në vitin 1947, ndonëse i sëmurë me tuberkuloz, martohet me një vajzë të thjeshtë nga Sukthi (Shijaku), Hafsa Mustafa Dervishin (Cajen). Me Cajen e njohu vajza e vëllait Xhibja, që e kishte komshie. Caja ishte dhe mbeti një grua besnike që i qëndroi pranë deri në çastet e fundit të jetës. Me Cajen ai ndërmori një turne të madh në viset e Shqipërisë, veçanërisht në Dibër dhe në vendlindjen e tij Zall Dardhë, ku mblodhi dhe përpunoi dhjetra këngë dhe valle popullore, të cilat i vuri me sukses në skenë deri në skenat e Europës dhe të botës, në vendet e Europës Lindore dhe në Kinë.

Fati i qëllui të mos kishte fëmijë. Për këtë arsye ai ju përkushtua me dashuri fëmijeve të vëllait të tij, Zenelit. Zeneli ka sot dy djem, Hajredinin që ka trashëguar emrin e babait të kompozitorit dhe Besnikun.

Tre dashuritë e mëdha të Muharrem Xhedikut

Kështu ai pati në jetë tre dashuri të mëdha; muzikën, Jelicën dhe fëmijët e të vëllait. Ai vdiq më 21 nëntor 1959. Vdekja ja rrëmbeu jetën në kulmin e krijmtarisë së tij, megjithatë ai ka lënë pas një trashëgimi shumë të madhe e cila ende nuk i është zbuluar plotësisht publikut.

Vlerat muzikore që na la trashëgim kompozitori Xhediku

Gjithsesi ai do të mbetet njëri nga baballarët e kultivimit të muzikës së lehtë shqiptare.

Pas çlirimit atij ju besua krijimi i filarmonisë shqiptare. Ai ka punuar si drejtues në korin e ushtrisë, është drejtori i parë i filarmonisë shqiptare, megjithese nuk përmendet. Ai ka shërbyer edhe si pedagog në shkollën e parë të muzikës në Tiranë. Njëherësh ju kushtua kompozimeve të këngëve të muzikës së lehtë dhe të përpunimit të këngëve burimore duke u bërë një ndër kompozitorët më të adhuruar të kohës. Ka marrë pjesë në koncertet dhe festivalet e kohës me ansamblin e këngëve dhe të valleve popullore brenda dhe jashtë vendit.

E veçanta e kompozimit të tij ishte se ai i shkruante vetë tekstet dhe i kompozonte mbi bazën e tabanit tonë kombëtar. Këngët si "Falmi syte e shkru", "Engjëllushes", "Matura" "Jelica" etj kanë mbetur edhe sot në kujtesën e asaj gjenerate si motivet më të bukura që i këndonin me pasion dashurisë. Është me të vërtetë kënaqësi kur dëgjon sot nga goja e rokerit Aleksandër Gjoka këngën e riorkestruar "Falmi sytë e shkru". Teksa dëgjon këtë këngë hit në ato vite, hit edhe sot, bindesh për motivin, muzikalitetin, koloritin dhe intonacionin e mrekullueshëm të këngëve të kompozitorit të pavdekshëm Muharrem Xhediku, që vjen nga vendi i artistëve sikurse është quajtur me të drejtë Zall Dardha e Dibrës.

Krahas muzikës së lehtë ai kompozoi edhe këngë popullore si: “Cuca e Radomirës”, “Hajde shpirt se erdh pranvera”, “Te kroni” etj. Mrekullohesh kur dëgjon nga Eranda Libohova këngën “Cuca Radomirës”.

Xhediku është kompozitori i parë që solli me profesionalizëm ritmet e muzikës së lehtë e sidomos të tangos në Shqipëri. Ai shkroi dhe kompozoi në të gjitha gjinitë e muzikës, jo vetëm këngë, por edhe romanca, pjesë për koncerte, suite orkestrale, opereta, muzikë vallzimi etj. Tangot e tij këndohen dhe kërcohen edhe sot.

Kam dëgjuar në original këngët e herëhme të Muharrem Xhedikut dhe jam impresionuar. Kur dëgjon Artistin e popullit Ramiz Kovaçi tek kënga “Bareshë e malit” shoqëruar në piano nga Margarita Kristidhi, të duket vehtja sikur je pranë burimeve të malit dhe mes cicërimave të zogjve. Një mrekulli muzikore që të jep natyrë dhe dashuri hyjnore. E veçantë të duket edhe kënga “Kur më zbret bregut”, kënduar nga Pranvera Baçe, këngëtare e grupit artistik të Korçës.

Me plot humor , por edhe me ndjenjë kënga e pleshtit , interpretuar nga artisti Hysen Pellingu. Kënga “Matura” ose “Unë për ty nuk do të shkruaj” në ato vite hymn i tangos shqiptare interpretohet me ndjenjë dhe pathos nga Anita Take. Mjaft interesant interpretimi i Gaqo dhe Luiza Çakos në këngën “E dua jetën” nën dirixhimin e Nesti Uçit. Dueti Anita Take dhe Xhavit Xhepa tingëllon shumë bukur tek kënga “Te burimi”. Muzika e vallzimit si në këngë ashtu edhe si orkestrale tek kënga “Në parkun e qytetit” të bën të vallzosh dhe të këndosh së bashku me Anita Taken. Zëri i Pjetër Gjergjit tek kënga “Lisi plak” (Shkruamë të vërtetën) tingëllon si bilbil mali. Dhe më tej dueti Pjetër dhe Floringa Gjergji tek kënga popullore e Xhedikut “N’at” livadh” duket sikur me të vërtetë valëzon nëpër livadhet dhe lëndinat shqiptare të bukura dhe të pafundme. Të befason zëri i ëmbël i Xhavit Xhepës tek kënga “Ja bilbili ligjëron” (Çelin lulet), një zë melodioz i padëgjuar në ditët e sotme, një zë që të kënaq shpirtin dhe të sugjestionon. Duetet Pjetër Gjergji dhe Anita Take vazhdojnë me këngët “Ndarja nuk na ndan” dhe “Të pres”, këngë karakteristike të tangos shqiptare të Xhedikut.

Hysen Pellingu shpërthen fuqishëm me lirizmin e tij karakteristik tek kënga “Cuca e Radomirës”, një mrekulli e këngës popullore dibrane. Ndërsa Viktori Xhomo tek kënga “Do ta gris çarçafin” paraqitet si një artiste e kompletuar e kohës.

Dhe në majë të këngëve të tangos shqiptare dhe të Xhedikut qëndrojnë këngët “Vashës sime”(Vajzë ëngjëllore) dhe “Falmi sytë e shkru” të kënduara nga Pjetër Gjergji.

Artisti i Popullit Avni Mula në kujtimet e tij për Xhedikun në mes të tjerave shkruan:

“Sa herë dëgjoj tingujt muzikorë të kitarës, sa herë shoh kitarë, më del përpara sysh figura e ndritur kolegut dhe shokut tim të nderuar kompozitorit të talentuar Muharrem Xhediku

**Ja disa nga këngët që na kanë mbetur nga krijimtaria e tij deri më sot
e pa studjuar dhe lëvruar plotësisht:**

1. Falmi sytë e shkru
2. Vashës sime (Vajzë engëllore),
3. "Matura" (Unë për ty nuk do të shkruaj)
4. "Jelica" (kushtuar të dashurës dhe më vonë gruas së parë të tij)
5. Pranvera e re
6. Fshatarja deputete
7. Do ta gris çarçafin
8. Kur dielli bie
9. Komisarja dëshmore
10. Erë pranvere
11. Këngë për hidrocentralin
12. Vashës trimëreshë
13. Do të ngremë së bashku digën
14. Kënga e të mërguarit (kurbetit)
15. Do të korr arat me kombajnë
16. Afërdita traktoriste
17. Syrin ma ke si filxhan
18. Bukuroshja shamikuqe
19. E para ndër shoqe
20. Lumi Matit, ujë dhe dritë
21. Shkëlqen Tirana
22. Zalldardhës trime
23. Tek burimi
24. Tek kroni
25. Pllumb i shkruar
26. Hajde shpirt se erdh pranvera
27. Hallet e bilbilit
28. Cuca e Radomirës
29. Maturantes
30. Lisi plak (Shkruamë të vërtetën)
31. Vendit tim
32. Trëndafili dhe zogu
33. Kanga e pleshtit (humoristike)
34. N'at' livadh
35. Në parkun e qytetit
36. E dua jetën
37. Të pres (Ndarja nuk na ndan)
38. Bareshë e malit etj etj

Kontributi i Xhedikut për kultivimin e muzikës së valleve popullore shqiptare

Xhediku ka krijuar, grumbulluar dhe vënë në pentagrame një gamë të madhe vallesh nga krahina të ndryshme të vendit. Këto valle janë përpunuar për orchestra dhe janë vënë në skenë nga ansambli i këngëve dhe valleve në Shqipëri dhe në skenat e Europës dhe të botës.

Vlen të përmenden Vallet: “Te kroni”, 2 Potpuri vallesh nga rrethi i Korçës, valle e Elbasanit, Valle e Pogradecit, Valle e Obotit, Shkodër, Vallja e prashitjes në Sohodoll të Dibrës, Vallja e lamës së grurit, në Sohodoll të Dibrës, vallja e shirjes në Sohodoll, vallja e grave të Sohodollit, valle e Myzeqesë, valle e Çermenikës, Valle e Anamalit, Shkodër, vallja e xhedikëve në Zall Dardhë, vallja e rëndë e burrave të Zall Dardhës, vallja koreografike e Lumës, vallja e Sllovës, vallja e Bilbilit në Nezhë të Zall Dardhë, vallja e grave të zall dardhës, vallja e burrave të Çidhnës, vallja karakteristike e Sinës, Vallja e Pejës, vallja e Gjilanit, vallje e burave të Prishtinës, valle gjirokastrite, vallja e Radomirës, Cuca e Radomirës (valle e kënduar), valle e grave të Zerqanit, vallja e rëndë e burrave të Dibrës së Madhe

Xhediku ka shoqëruar grupet artistike jashtë Shqipërisë duke qenë instrumentist dhe drejtues orkestre.

Pas viteve '50 të shek XX, vihet re tendenca e zgjerimit të repertorit të këngeve popullore të përpunuara, si dhe atyre krijimeve me frymë popullore, të cilat kanë kompozitor por që për shkak të përhapjes së tyre mbarëkombëtare njihen si popullore. Ndër to përmendim: “*Erdh pranvera*”-Pjetër Dungu; “*Lumja unë për ty*”-L. Lekaj; “*Te kroni*”-M.Xhediku; “*Lule borë*”-S.Gjoni; “*Oj Oçe*”-Tish Daija; “*Çili sytë se du me t’pa*”-Çesk Zadeja; “*Çuçurrushja*”-Ramadan Sokoli etj. Shumë këngë të kësaj natyre, janë edhe ato të kompozuara nga kompozitorët kosovarë si p.sh: “*Baresha*”, e kënduar nga Nexhmije Pagarusha me muzikë të Rexho Mulliqit; “*Zambaku i Prizrenit*”-Akil Koci; “*Trëndafilat e Gjakovës*”-Esat Rizvanolli; “*Djem e vajza*”-Vinçenc Gjini; “*O moj bukuroshe*”-Zef Tupeci; “*Prishtinës*”-*Sevime Kabashi etj.* Ndër kompozitorët dhe muziktarët shqiptarë që kanë përpunuar thellësisht këngën popullore shqiptare përmendim Çesk Zadejën, Tish Dainë, Limoz Dizdarin, Gjon Simonin, Aleksandër Peçin, Milto Vakon, Agim Krajkën, Xhemal Lacin etj.

Xhediku dhe Prodani dy themeluesit e muzikës së lehtë shqiptare

Muharem Xhediku lindi në një mjedis muzikor popullor, studjoi në Konservatorin e Bolonjës, në Itali, ndonëse kurrë nuk u mburr, por përkundrazi e mbajti sekret dhe kompozoi në një kohë kur shumë muzikantë shqiptarë ose nuk ishin shkolluar ende, ose po shkolloheshin në Moskë. Xhediku bashkë me Kongolin dhe me pak muzikantë të tjerë të atij brezi i përket muzikantëve që u shkolluan në Përëndim, por për arsye të politikës së kohës as që e përmendën atë.

Ndonëse ishte vetëm Radio Tirana, ajo godinë e vogël në Rrugën e Kavajës, vetëm Estrada e Tiranës, edhe ajo e njësuar me ansamblin e këngëve dhe valleve dhe filarmoninë shqiptare, Xhediku përsëri gjeti hapësira për të krijuar atë që i mungonte popullit në atë kohë, të sapodalë nga lufta, muzikën e lehtë. Filloi të krijonte muzikë vallzimi si ato me titull: “Në mbrëmjen e dëfrimit”, “Në takim” “Në park” etj, këngët e famshme që u bënë baza e tangos shqiptare si “Falmi sytë e shkru” “Matura”, “Jelica” etj.

Mbrëmjet e vitit të ri dhe mbrëmjet e ashtuquajtura tematiko-dëfrimi u mbushën me muzikën e vallzimit që krijonte me kitarën e tij Muharrem Xhediku.

Jo vetëm kompozitor por edhe autor i teksteve të këngëve të veta

Po të analizosh tekstet e këngëve të Muharrem Xhedikut bindesh se ai ishte jo vetëm kompozitor por edhe një poet i vërtetë. Cdo varg i tij është shkruajtur me ndjenjë dhe jo për të rregulluar rimën apo ritmin e muzikës.

Le të shikojmë me vëmendje tekstin e këngës “Cuca Radomirës”

Të gjithë e dimë se Radomira është një fshat piktoresk në bjeshkë të Korabit dhe kjo cucë e këtij fshati domosdo do të jetë e vecantë , punëtore dhe e bukur.

Cuca Radomirës faqet me nishana
Tuj e korrin grunin oe e ka zanun hana

Cuca Radomirës, flokët kaçurrela
Çi punojnë shtizat oe tuj e mush bucela

Cuca Radomirës tuj prashit ndër ara
Nuk ka asnji djal katundi që ti dal përpara

Cuca e Radomirës, synin si shkëndi-e
Lumi ai trim i zoti oe që do e shtjer në shpi-e

Dashuria për fëmijët dhe kompozimi i këngëve për ta

Xhediku i donte shumë fëmijët dhe ka kompozuar disa këngë për fatosa e pionerë dhe disa pjesë muzikore për fëmijë. Akoma ka mbetur në mendjet tona kënga për fëmijë Rona, Rona Pipirona, me tekst të Spiro Çomorës dhe me muzikë të M.Xhedikut.

Rona, Rona, Pipirona

U mbush kopështi milingona
Lozin e punojnë
Kopështin zbukurojnë
Rona, Rona, Pipirona
Ne nuk jemi milingona
Jemi lulet e shtëpisë
Dallëndyshet e Shqipërisë
.....

Bashkëpunimi me poetë dhe shkrimtarë të tjerë të shquar

M.Xhediku si një muzikolog i talentuar , krijues në të gjitha gjinitë muzikore përveç teksteve të tij bashkëpunonte edhe me poetë dhe shkrimtarë të tjerë të kohës. Kryesisht spikat bashkëpunimi me Spiro Çomorën dhe me Fadil Krajën.

Gëzo pranverën

Muzika M.Xhediku
Teksti F.Kraja

Të kam thanë se je e bukur,
mori Meliha
Po unë i mjeri, mori flutur
Kurrë nuk të kam pa

N'çarçafë të kanë mbulue
Mori vashë e re
E nuk po mundesh me gëzue
Sot jetën e re

Shoqet tuaja të gjitha qeshin
E me gëzim punojnë
T'ardhme të lumtur aro presin
Kurse ty të ndajnë

Ç'ka fitokan prind't prej teje
Që të kanë mbulue
Çou vashë e dashtun, akullin theje
Mos rri tuj vajtue

Gëzoje botën që po veshet
Plot me lule mblu
Gëzo pranverën që po qeshet
Sot për ty e mu.

Çak e çuk ç'bën atje
Muzika: M.Xhediku

Teksti: S.Çomora

Çak e çuk ç'bën atje
Bëj lakror me kokeve
Të ja shpie burbuqes
Buqe faqekuqes
Që nget një traktor në arë
Dhe lëron e mbjell farë
Me traktor në arë
Po na mbjell farë

Çak e çuk ç'bën atje
Bëj lakror me kokeve
Të ja shpie burbuqes
Buqe faqekuqes
Që nget një traktor në arë
Dhe lëron e mbjell farë
Që ngarkon lëmin e parë
Dhe e shpie në hambarë.

Disa nga tekstet e këngëve të kompozitorit Muharrem Xhediku

Te burimi i kulluar (Ëngjëllushes)

A të kujtohet ditë e majit,
kur ne shkuam në piknik
rrëzë burimit afër malit
Ti më zgjodhe mua për mik.

Sa të qeshë n syt' e shkru
kur të thash
sa shumë të du,
një kujtim të paharru,
nga zemra vajz' ta kam dhuru.

Refreni

Hajt të shkojm' tek burimi i kulluar
të pushojm' pranë lisit të bleruar
lule maji plot aroma
tufa tufa do ti mbledh
manushaqet më të njoma
veç për ty, moj, do ti zgjedh.

Me dafina lule fushe
një kunor do të baj për ty
veç për ty moj ëngjëllushe
sa në zemer më ke hy.

Matura

Sa të marr dhe unë maturën
o i dashur, veç më prit.
Se në skajet më të largta
do të takohemi një ditë.

Refreni

Unë të prita por ti s'erdhe
shum' të prita
ndaj s'të pres

ti s'u skuqe
as u zverdhe
kur më dole e pabes

Jeta e fshatit
s'të pëlqeu
ndaj një tjetër dashurove
besën moj që s'e tret dheu
vall' ç'e bëre, ku e çove ?
besën moj që s'e tret dheu
vall' ç'e bëre, ku e çove ?

II

Ti s'e don zemrën bujare
që të pret i përmallu
Po ta dija lozanjare
s'do të të kisha dashuru

Refren...

unë të prita por ti s'erdhe....

Trëndafili dhe zogu

Gem me gem zogu fluturon
tek një trandafil ai shkon qëndron
Se kjo gonxhja çel o për bukuri

porse zogut mjer hallin nuk ja di
se kjo gonxhja çel o përbukuri
porse zogut t'mjer hallin nuk ja di.

Refren

kno bilbil pra zogu i verës
thuja kangës dhe një her'
thuja kangës dhe një her'
o në këtë pranver'

**Prap erdh pranvera
(Vajzë ëngjëllore)**

Vajzë ëngjëllore
Zemrën ma more
U ngjite lart po prap
s'guxon për me u kthy

Sa të dashurova
Sa të adhurova
Në çdo moment
mendja më rrin
vetëm tek ti

Si munde të harrosh
Sa herë më bane be'
Si munde t'mos kujtosh
besën që lidhëm ne

Refreni

Ti vetë më the se lumturia
S'fitohet kurr jo me para
Kur është e pastër dashuria
Hare dhe gzime ajo ka

Vërtet i varfër unë qëllova
E noj stoli s'ta kam dhuru
Por me gjith shpirt të dashurova
Zemrën veç ty ta kam dorzu
Kur bridhnim ne n'livadhe blert

II

Prap erdh pranvera
si motet tjera
manar i vogël kodër m'kodër blegëron
zogjt cicërojnë
çerdhe ndërtojnë
veç zemra ime natë e ditë për ty mendon

Si munde të harrosh
Sa herë më bane be'
Si munde t'mos kujtosh
besën që lidhëm ne

Refren

Kur bridhnim ne n'livadhe të blerta
të qeshur, të gzuar si fëmij
ti m'thoshje me fjal' të singerta
se unë ta fala dashurinë

Gëzimin e jetës mua ma more
e në harresë mua më le
nga natyra dukesh ëngjëllore
por në zemër akull je.

Cuca Radomirës

Cuca Radomirës faqet me nishana
Cuca Radomirës faqet me nishana
Tuj e korrin grunin oe e ka zanun hana
Tuj e korrin grunin oe e ka zanun hana

Cuca Radomirës, flokët kaçurrela
Cucë e Radomirës, flokët kaçurrela
Çi punojnë shtizat oe tuj e mush bucela
Çi punojnë shtizat oe tuj e mush bucela

Cuca Radomirës tuj prashit ndër ara
Cuca Radomirës tuj prashit ndër ara
Nuk ka asnji djal katundi që ti dal përpara
Nuk ka asnji djal katundi që ti dal përpara

Cuca e Radomirës, synin si shkëndi-e
Cuca Radomirës, synin si shkëndi-e
Lumi ai trim i zoti oe që do e shtjer në shpi-e
Lum ai trim i zoti oe që do e shtjer në shpie-e

Ç'është' më e bukur në këtë botë

Ç'është' më e bukur në këtë botë
Ftyra e gocës, hën' e plotë
Oh, oh, hën' e plotë.

Gjumin e natës kush ta tret
Syni i gocës si magnet
Oh, oh, si magnet.

Kush të shkrin porsi qiri
Syni i gocës filxhanli
Oh, oh, filxhanli.

Ç'është më e embla në pranverë
Buza e gocës si sheqer,
Oh, oh si sheqer.

Hajde shpirt se erdh pranvera

Hajde shpirt se erdh pranvera
Çelën lulet përsëri
Vjollca të njoma e lulëshqera
Do të mbledh, shpirto, veç për ty.

Këndon bilbili tek qershia
Nga merak u flakë u ndez
Oh, trandafilat ndër avllija
Zbërthejnë gonxhet pa kujdes

.....

Unë të dashuroj

Moj vashë vetullkurore
Ç'e ke shtrënguar aq fort
Belin e hollë ?

Ti vashë burbuqe je
Që kur të pashë
Mua gjumi s'më ze.

Fol vashë, moj gjerakinë
Përse ty djemtë
Rreth e qark të vijnë ?

Fol vashë burbuqe moj
Se unë moj xhane
Fort të dashuroj.

Të lumtur zemrën ti ma bane
Me buzëqeshjen tande
Se unë të dashuroj.

Ti pëllumb i shkruar

Ti pëllumb i shkruar
Atje, tej në bregdet
Asht duke punuar
Vasha që dua vetë.

Asaj syzezës sime
Falju pak për mua
Tregoi me ligjërime
Se sa fort e dua.

Në shtëpinë e vashës
Ti pëllumb qëndro
Dhe me kangën e paqes
Zemrën ja gëzo.

Asaj syzezës sime
Falju pak për mua
Tregoi me ligjërime
Se sa fort e dua.

Kur dielli bie

Kur dielli bie
Dhe hëna nis me dalë
Unë dhe ti

Bëjmë dashurinë e parë.

Oh, sa më gëzon
Moj syri yt i zi,
Kur ti më don
Unë kam çdo lumturi.

Se kam durue
Katër vjet me rradhë
Për sytë e tu,
Kushdi sa kam qarë.

Oh, sa më gëzon
Moj syri yt i zi,
Kur ti më don
Unë kam çdo lumturi.

Lisi plak

Lisi plak rrëzoi fletët
Edhe bryma prapë ra kudo
Pa shkruamë vashë ti të vërtetën
Më do ti mua apo s'më do ?

Ti ike larg dhe më s'u ktheve
Dhe letër më shkrove ti
Të pres , të pres me padurim
Tek lisi plak si një kujtim

Çdo gjë të shtrenjtë e kishim bashkë
Ndaj rri e mendoj për dashurinë
Letrën që më shkrove ti
Do ta mbaj me dashuri.

Do të të pres me padurim
Do të të mbroj me dashuri
Dhe së bashku do të qëndrojmë
Do të gëzojmë në folenë tonë
Si dy të rinj....

.....

Falmi sytë e shkru

S'di se përse
gjumi natën nuk më ze.
ti dhe vetëm ti,
gjithnji në mendje më rri.

Eh, eja pak
xhani mu dogj zjarr e flak.
ti dhe vetëm ti,
gjithnji në mendje më rri.

Atë nat' pranvere
kur ty të pash',
zemrën menjëher'
un' ty ta dhash',
Qetësi nuk gjej
Ngado që shkoj
Vetëm pranë teje
Dua të rroj.

Refreni

Të lutem falmi syt e shkruar
që si prush jan tuj mpërvlu
pas syve të tu jam dashuruar
e s'po munem me duru

Qerpiku yt i rand
më fal gëzim e lumturi,
Shkëlqimi synit tand
zemrën ma mbush me amëlsi.

Refreni

Të lutem falmi syt e shkruar
që si prush jan tuj mpërvlu
pas syve të tu jam dashuruar
e s'po munem me duru

Çelin lulet në pranverë

Çelin lulet në pranverë
Manushaqe e luleshqerë
Trandafilat kur shpërthejnë
Seç na dehin me erë.

Ja bilbili ligjëron
Trandafilat i këndon
Flet' e gonxhes kadife
Këngën e re dëgjon,

Seç u çel trandafili
Seç u duk gjethi i ri
Kur ja thotë bilbili
Këngës për dashuri
Po ti vashëza ime,
Vallë ti a e dëgjon ?
Se me ca përgjërime
Zemra ime t'kërkon.

Ja bilbili ligjëron

.....

Qeshur hëna lehtë e lehtë
Përmbi lumin po rrëshqet
Tej e tej mbi ujë noton
Dhe me mall këndon.
Kanarina n'gem të ri
Përsërit një melodi
Dhe bilbili që e don
Pranë i fluturon.

Seç u çel trandafili

.....

Midis traktoristëve

Prit moj vajzë
Prit dhe pak te porta
Krahët e mija
Janë shumë të forta

Mos e merr me kaq nxitim

Do ta shkojë traktori im

Ç'ke mor djalë
Ç'ke që rri menduar
Unë traktorin
Sot s'e kam pastruar

Vajzë e djalë

Kanë hyrë në garë

Kush e kush

Të lëvrojë më parë

.....

Të shpejta mi ke duart

Të shpejta mi ke duart

Moj vashëza punëtore

Në fabrikën tonë të re

Ti ke qëndis fitore

Të ëmbël mi ke sytë

Të qeshur si pranvera

Ndër lule je më e bukura

Të zgjedha ndër të tjera

Në zemër më ke hyrë

Me shpirt të dashuroj

Kur të shoh me llërë përveshur

Më shumë unë do të punoj

Fshatarja deputete

Ç'po më vjen çudi

Moj e mira nanë
sa larg paska mbrijt
Vogëlushja Zanë
Unë e mbaj mend hollë
Kur hyra në ushtri
Zana ish pa shkollë
Shkonte me bagëti
Ashtu biro se
Koha që kaloi
porse bashkë me ne
Edhe ajo ndryshoi
.....

Pranverë e re

Sa e gëzueshme vjen pranvera
Plot me lule zbukurue
Punojnë vashat krah shpërvjela
Nëpër arat tuj këndue

Sa e bukur kjo pranverë
Ardht' e bardhë kurdoherë

Tufë e dhenve të blegtorit
Janë shtuar mizëri
Edhe plugjet pas traktorit
Tokën çajnë me lehtësi

Sa e bukur kjo pranverë

Ardht' e bardhë kurdoherë

Çahen malet, thahet kënetat
Shumë e gëzueshme kjo pranverë
Tashti njerzit kanë n'duart e veta
Çka s'kanë pasur asnjëherë

Sa e bukur kjo pranverë

Ardht' e bardhë kurdoherë

Do ta gris çarçafin

Lermë mori nanë të shkoj në fabrikë
Eja të të përqafoj, shoqet janë tuj m'pritë.
Do të end pëlhura, basma ngjyra ngjyra
Lermë mori nanë, të shkoj në fabrikë
Do të gris çarçafin dhe perçen e zezë
Një fustan me lule ty nanë do të ta pres

Do të end pëlhura basma ngjyra ngjyra
Do të gris çarçafin dhe perçen e zezë.
Dua të dallohem si sulmonjëse e parë
Dua të martohem me një trim beqar
Do të bëj pëhura , basma ngjyra ngjyra
Dua të dallohem si sulmonjëse e parë.

Shkëlqje Tiranë

Seç po gëzohet gjithë republika

Populli mbarë po kremton
Ndër kombinatë, uzina, fabrika
Këngë e Tiranës sot ushton.

Ti kryeqendër e Shqipërisë
Sa vjet lavdije po kalon
Për përvjetorin tënd të lirisë
Botë e tërë të përgëzon.

Shkëlqje Tiranë ngadhnjimtare
Kryeqytet i dashur ti je
N'rrugët e tua legjendare
Kënga buçet për jetën e re.

Çdo kënd e rrugë e çdo gur shtëpie
E çdo kodrinë e çdo shesh që ke
Simbol përleshjesh dhe lavdije
Gjithmonë i shtrenjtë do mbetet për ne.

Kushdi sa pallate do të shtohen
Parqe e shkolla krejt të reja
N'rrugët e tua të rinjtë shëtisin
Të lirë e të qeshur krah për krah.

Shkëlqje Tiranë ngadhnjimtare

.....

Dëshmoret partizane

Errësirë e natës mbulon dhenë
S'dëgjohe zë përveç stuhisë

Po Sokoli ç'ka vallë që nuk flen

Mos e djeg zjarri i dashurisë ?

Në çetën tonë çlirimtare

Ajo erdhi të luftojë për liri

Dhe këtu gjen shoqen komisarë

Që e pati njohur në fëmijëri

E kishte dashtë Dritën Sokoli

Që kur kullosnin qëngjat bashkë

Dhe tash me zjarr ajo i foli

“Që llo armikun pa u drashtë”

Si shkabë e malit ajo sulmoi

Përmbi armiq e tradhëtorë

Gjersa një plumb në gjoks e shpoi

Dhe i preu hovin rinor.

Kur çeli sytë ai pa Dritën

Pranë të plagosurve të vijë

Me duart e saj copton këmishën

Plagët u lidhën me dashuri

Fort u gëzua dhe vajza trime

Kur çetë e saj triumfoi

Edhe mundimi kot s'I shkoi

Sokolit jetën ja shpëtoi

Lufta gjëmonte në çdo anë

Vdekja i afrohej robërisë

Mbi malet plot me partizanë

Buçiste kënga e lirisë

Në një betejë vendimtare

Që vendit tonë i dha fitore

Oh, se ç'u vra një komisare

Oh, se ç'u shtua një dëshmore

Për shoqe jete të pata zgjedhur

Për shok jete më deshe dhe ti

Por dashurinë e mbanim fshehur

Se kishim tjetër dashuri

.....

Nga malet djaloshi zbriti

Nga malet djaloshi na zbriti

Me pushkën e dashur në dorë

Diku në një kasolle trokiti

Në pyllin mbuluar me dëborë.

Gëzimin s'e fsheh trimëresha

Djaloshin me mall përqafoi

Shumë kohë të kam prit, tha baresha

Shumë vjet veç për ty unë mendoj

Sa male, sa shkropa kalove

Në luftën e shenjtë për liri

Po plagët , ti, ku i mjekove ?

I flet vasha plot ëmbëlsi.

Kur binte për sulme borija

Në zjarre të shpeshta ne ramë

Kur frynte tërbuar stuhija

Ne vdekjen shumë afër e pamë.

Dhe vasha e djali gëzohen

Për jetën e re që do të vijë

Dhe zemrat në heshtje betohen

Të rrojnë së bashku gjithnji

Në brigje luginat ushtojnë

Kur këngës ja thotë çifti i ri

Për t'ardhmen e bukur këndojnë

Për jetën më pas dhe lirinë

.....

Xhediku ka krijuar edhe tekste dhe melodi për parodi gjatë kohës që punonte në estradë. Ja disa prej tyre:

Nuk punon motorri

Në një autopark

Një drejtor njëherë

Për një rrugë të largët

Ngarkon një shofer

Porsa del te dera

Shoferi mendohet

Këto ditë nga baza

S'ka qejf të largohet
Kjo rrugë s'ka fitim
Nuk ka myshterinj
Pastaj koha jashtë
Është baltë e shi
-Dëgjo lum drejtori,
Seç bela na polli
Me gjithë qejf do veja
Por s'punon motorri

Doktori esnaf

Na ish një farë kohe
Një doktor esnaf
Nuk ish shumë i pasur
Por kishte taraf.
E patën mësuar
Si të rrjepte botën
Mos bënte vizitë
Pa ja lyer rrotën
Tani miqtë vdiqën
Vanë në botën tjetër
Po esnafi ynë
Mban zakonin e vjetër.
Kur e lut i sëmuri
Shpejt ja kthen doktori
Po s'e lyeve rrotën

Nuk punon motorri.

Sekretet zyrtare

Në një tavolinë

Pa vrarë mendjen fare

Një shok nxjerr kutinë

Dhe na jep cigare.

Ne e falenderojmë

Bujarinë e tij

Por diçka lexojmë

Shkruar mbi kuti...

E ku është parë

More mendje lehtë

Sekrete zyrtare

Të shkruhen në paqetë ?

Ku i mban shënimet

Lumi që s'të mori

Bëj ca riparime

Se s'të punon motorri...

Krijime të tjera kushtuar veprave të dritës dhe punës së njerëzve

Liqenet mbi Drin

Drini i Zi plot tërbim

Sulet grykave rëndë rëndë

Por rinia me guxim

Rrugën atij do tja zërë.

Dhe atëhere i gjori lumë

Do të bjerë si në gjumë

Porsi deti i valëzuar

Do të shtrihet fort i kulluar

Malet tona shkëmb e gurë

Si n'pasqyrë kanë për tu parë

Ky vend veshur si askund

Ndryshe krejt ka për të ngjarë.

Do lundrojnë barkat tona

Miq në vjeshtë dhe në pranverë

Buzë liqenit n'orët e vona

Do të shëtisin të rinjtë përherë.

Do të korr arat me kombajnë

Hënë moj, e dashur hënë

Ndale pakëz endjen tënde

Unë me ty do të bisedoja

Ca sekrete të ti tregoja.

Sot jam tepër e gëzuar

Miku im është dekoruar

Tërë shokët e uronin

Kombajnerin e lëvdonin.

Pastaj bashkë u takuam

Sy ndër sy u shikuam

Tek po korrnim grurin në arë

Unë me shoqet bëja garë.

Kombajneri atë ditë
Disa herë mu vardit
Që edhe unë paskëtaj
Të korr arat me kombajnë

E pastaj e dashur hanë
Më tëhoqi në një anë
Diçka deshi të më tregojë
Por i mbeti fjala në gojë.

Kur të mësoj, e dashur hanë
Të korr arat me kombajnë
Mikut tim do ti hap garë
Dhe flamurin do tja marr

Unë atij e dashtun hanë
Shpirt e zemër ja kam dhanë
Bashkë përherë do të punojmë
Të gëzuar do të jetojmë.

Në parkun e qytetit

Kur lulëzojnë tërfilat
Dhe ligjërojnë bilbilat
N'parkun e qytetit sa gëzime
Trëndafilat zbërthejnë
Pionerët kërcejnë

Bashk' me to gëzon dhe zemra ime.

Gjithkund argëtime
Ajër, lule, gjelbërime
Buçasin këngët në liri

Kur lulëzojnë tërfilat
Dhe ligjërojnë bilbilat
Parku na sjell lumturi.

Ja dhe vasha syzezë
Letrën këndon plot shpresë
Që i erdhi nga Dibra mëmë
Ti moj xhane mos druaj
Dashurinë ma ruaj.

Zemra ime gjithmonë ty të don
Në Tiranë ne po mësojmë
Se si duhet të punojmë
Atdheun ta lulëzojmë

Ti moj xhane mos druaj
Dashurinë ma ruaj
Pa do të rrojmë së bashku
Përsëri...

Vasha dhe trimi

Kur këmishëzinjtë
Shqipninë robnuen
Vasha dhe trimi
N'çeta u takuan

Luftojnë së bashku

Gjersa fitojnë

Gjersa Atdheun

Krejt e çlirojnë

E pas fitores

Puna i ndan

Por shoqi-shoqit

Besën ja dhanë

Shpejt do të arrijë

Dita gazmore

Vashës dhe trimit

Tu ndrisë kurora.

Po zbardhon drita

Ç'po tundet fshati

Lajmërohen krushqit

Të bëhen gati

Se ç'po buçasin brigjet

Brigjet e zallet

Se do t'martohen

Trimat e malit.

Porsa dëgjohet

Lajmi gazmor

Ç'u mbushën udhët

Plot me dasmorë

Çe mbuloi dheun

Kënga e jetës
“U trashëgofshi
Trimat e çetës.”

Do të ngremë digën

Shumë ditë gazmore
Po shijon veëgjëlia
Vepra madhështore
Ndërton puntoria

Ku më parë ish kënetë
Ngrihen kombine
Populli për vehte
Po ndërton palate

Ujët e kulluar
Që buron në Selitë
Ne e kemi detyruar
Të na japë dritë.

Dhe nga lumi i Matit
Ne nuk kemi frikë
Përpara afatit
Do ti vemë digë

Kur të ngrihet diga
Do t’ lind energjia
Do t’përhapet drita
Të ndriçojë Shqipëria.

Erë pranverore

O fllad i lehtë, o erë pranverore
Që përkëdhel vendin tim
A ka vallë në botë të tjera bregore
Veshur kështu me blerim ?
A ka në botë vallë të tilla lugina
Ku mollët lulëzojnë ?
Ku djemtë petrira, vajzat gjeraqina
Me gaz punojnë dhe këndojnë ?

Shqerkat në livadhe
Një tufë e bashkuar
Lozin e kullosin
Në barin e ri
Eja moj sorkadhe
Mos rri mënjanuar
Zemrat ti bashkojmë
Në punë e lumturi

O fllad i lehtë, o erë pranverore

.....

Ti s'ke zemër

Oh, sa gëzueshëm gjithçka për rreh
Mbramjeve kur të kam pranë
Vetëm dyshim mua zemrën ma bren
Se mos ti vallë mua më gënjen.

Ti nuk ke zemër
Që më ban të vuaj

Flakën që ndeze ti
Kurrë nuk mund ta shuaj

Ti je plot naze
Dhe tallesh shpesh me mua
Kurse unë jetën
Pa ty s'e dua...

Ti nuk ke zemër

.....

Afërdita traktoriste

Në katund akoma s'ka dalë drita
S'ka kënduar ende gjeli i parë
Veç traktori që nget Afërdita
Nëpër ara nis e çan ugar.

Kthehet toka plisa plisa

Dhe bilbilat nëpër lisa

Këngës ja kanë marrë me hare

Afërdita mbi traktor

Zemra i qeshet në kraharor

Se punon për jetën e re.

Zemr' e vashës digjet porsì zjarr

Për flamurin me yj si flori

Për flamurin që fitoi në garë

Ai djaloshi sy e vetullzi.

Kthehet toka plisa plisa

Dhe bilbilat nëpër lisa

Janë duke kënduar
Afërditës mbi traktor
Zemra i qeshet në kraharor
Vetullziu për nuse e ka kërkuar.

Syrin ma ke filxhanli

Syrin ma ke filxhanli
S'ta di shoqen në shtatë vllazni
Po t'këndojnë kangë moj, djemtë e ri
Dy nga dy me çifteli.

Shumë kangë ti kanë qit ty
Po t'këndojnë vetulla, po t'këndojnë sy
Po t'këndojnë shtatin si selvi
Po t'këndojnë faqet pjeshkali.

Lumi unë që t'kam komshi
E shyqyr që jam i ri
Kur mërzitem vij e rri
Tash një vjet të marr në shtpi.

Vashës sime

(Kufitarit)

Ti dallëndyshe që shkon fluturim
Kur të kalojsh atje mbi fshatin tim
Mbi fshatin tim ku bilbilat ligjërojnë
Dhe njerëzit së bashku të gëzuar punojnë

Atje kërko një vashë

Kërko atë vashën që zemrën ja dhashë

Vashës mi thuaj ti

Se trimi i saj po bën roje në kufi.

(Përsëritet dy herë)

Ti dallëndyshe që shkon fluturim

Kur të pushosh atje mbi fshatin tim

Thuaj një këngë me afsh pranveror

Këngën më të bukur për njerëzit punëtor'

Atje kërko, atje.

Thuaju me këngën që din ti më mirë

Le të punojnë të qetë dhe të lirë

Le të punojnë dhe të gëzojnë

Roje besnike në kufi ne qëndrojmë

Atje kërko, atje.

Bareshë e malit

Mbi maja të larta

Ku rriten shqipet

Ç'po këndoka

Një bareshë.

Këng' e përmallshmë

Ndër ahe mbytet

Dhe shpirtin

Ta çon peshë.

Diell i mesditës

Mbi krye çohet
Rrezja e nxehtë
Përvëlon.

Zemra e çikës
Seç po frigohet
Për trimin
Që dashuron.

Trimi i bareshës
Ruan në kufi
Trimi i bareshës
Mbron me guxim.

Moj e keqe

Moj e keqe, e keqe të thonë
Mjera ti moj përgjithmonë
Po bjen herët, po çohesh vonë

Çohu moj, mos pritsh me u çu
Del tek dera dhe rrin si hu
Se t'kan shku shoqet me punu
Çohu, moj çohu e u ngrifsh si borë
Del tek dera dhe rrin si sorrë
Se t'kanë shku shoqet për me korrë
Çohu, moj çohu, gjumë keqja gru
Shkon në magje me gatu
Duart pa la, kryet tuj kru
Çohu, çohu gjumëkeqja gru

Rrok dy shtamat dhe shko në kru
Njanën thy e tjetrën harru.

Mikes së dashur

Çeli pjeshka ndër kopshtije
Dhe qershija po lulëzon
Ja djaloshi nëpër hije
Këngës vashës ja këndon.

Sado larg që je moj mike
Thellë në zemër të mbaj ndry
Vashë e qeshur leskovike
Ditë e natë mendoj për ty.

Kur studionim të dy bashkë
Ti më thoshë shpirti im
Kur Tiranën unë e lashë
Ti më bëre një betim.

Sa mendime e sa plane
Njëri tjetrit ja treguam
Ti më the se lumninë tëndë
Në fshatin tim don me e ndërtue

Eja pra e dashtun mike
Thellë në zemër të mbaj ndry
Vashë e qeshur leskovike
Ditë e natë mendoj për ty.

Bukuroshe shamikuqe

Moj e bukura shami kuqe
Kallzot bacës kur shkon nuse
Du me u dalë përpara krushqve

Po të mëson dada, ty mor djalë
Krushqve para ti mos u dalë
Se janë zgjedhur në dhjetë mëhallë

Ti po qet besa një me dalë
Por ty t'xanë mandej rob të gjallë
Mban me qit djalo pushkë mbi kalë.

Në kopështin lulzon qershija

Jashtë në kopësht lulëzon qershija
Dhe blerojnë gjethet një nga një
Matanë lumit jehon melodia
Ligjërojnë bilbilat përsëri

Jashtë në kopësht hëna ka ndriçue
Që nga dëgjojmë një melodi
Ti më prit në orën e caktuar
Se do të vi unë patjetër tek ti.

Pse s'më vjen o, i dashur përsëri
Kujt ja ke vënë synin tani
S'më vjen keq se ti mua më le
Por më vjen keq se njerzit flasin për ne.

E para ndër shoqe

Mu në mes të sallës

Vajza ç'na foli
E para ndër shoqe
Për në Mat na doli

O Vashë të lumtë
Besën ti ma dhe
Neve të dy bashkë
Do të shkojmë atje.

Shkëmbejtë e Matit
Do t'i bëjmë thërrime
Sulmues do të dalim
O moj zemra ime.

Jeta e tij e vështirë është pasqyruar më së miri në këngën e tij të titulluar:

” Kanga e mërgimtarit”

Vaporri me të të mërguar
Ikën larg në det
Ca zogj janë afruar
Strehë për me gjetë.
Zogjtë kur i pashë
Oh, se ç'më kujtuan
Një të dashur vashë
Që për mua vuan.

Kalojnë dy tre dete
Ja edhe një det tjetër

Herë duket një ishull
E herë një varkë e vjetër
Në thellësi të detit
Ujët kur e pashë
Mu bë sikur ishe
Ti , o e shtrenjta vashë.

Se larg atdheut zbresin
Nëpër vende të huaja
S'ka kush të na presë
As nana, as fëmija, as gruaja.

.....

Nga opereta e Xhedikut

Xhediku ka shkruar edhe opereta. Fatkeqësisht nuk i gjejmë tekstet dhe partiturat e plota të saj. Një nga operetat e tij i kushtohet luftës për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave në fshat, emancipimit të gruas shqiptare. Ajo është një operetë tragjiko-komike dhe titullohet “Lugati” (Fantazma).

Personazhet e saj janë Baftjar Zamani , një fshatar tipik, Gëzimi, i biri, Drita , vajza e vogël, hoxha I katundit, e shoqja e hoxhës, një shkesë profesioniste, Xhevrija e fejuara e Gëzimit dhe mësuesja.

Ngjarjet zhvillohen në një fshat fill pas Luftës nacionalçlirimtare dhe tehu drejtohet ndaj zakoneve dhe veprimeve në dëm të grave dhe vajzave , të cilat shumica ishin të pashkolluara dhe të shtypura. Mbrojtja e dinjitetit të femrës ishte , pra një mision i letrarëve dhe artistëve të shqetësuar si Muharrem Xhediku me shokë.

Po japim një pjesë të shkëputur nga Kori i operetës:

I pari: A- Po vjen nusja duke qarë nën duvak

B- Po ky dhëndrri si s'u bëka hiç merak

A- Pse nuk del ta ngushëllosh, dhëndëro ?

B- Ç't'i thotë nusezeza kur s'e do ?

Bashkë: O bobo , me të vërtetë

Si do të ngryset gjithë kjo jetë ?

Me një nuse që s'e do

U bubu dhe o bobo !

**Simpozium shkencor kushtuar jetës dhe veprës së Muharrem Xhedikut ,
me rastin e 65 vjetorit të lindjes**

Me 26 qershor 1982, në Zall Dardhë të Dibrës, në vendin e lindjes dhe me rastin e 65 vjetorit të kompozitorit Muharrem Xhediku u organizua një simpozium shkencor kushtuar veprës së këtij kompozitori të shquar. Në këtë veprimtari morën pjesë punonjës muzike dhe arti nga e gjithë krahina e Dibrës, nga e gjithë Shqipëria, por peshën kryesore të këtij aktiviteti e mbajti Shtëpia e Kulturës Zall Dardhë me drejtor Xhelal Çerpen, e cila kishte edhe një grup artistik me traditë. Mori pjesë dhe foli në emër të Komitetit Shtetëror të Kulturës dhe të Arteve kompozitori i njohur, artisti i popullit Çesk Zadeja, kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Dibrës Rakip Dançe, Artisti i Merituar Hazis Ndreu, kryetar i degës së Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të rrethit të Dibrës etj.

Përveç Çesk Zadesë në këtë simpozium folën Hazis Ndreu, Mexhit Prençi, Sulejman Dibra, Bashkim Mërtiri, Xhelal Çerpja etj.

Kompozitori Çesk Zadeja, bashkëkohës i Muharremit ndër të tjera tha: "Shpesh këngët e bukura , të kompozuar me frymëzim dhe ndjenjë të hollë poetike, që kanë transmetuar idealet e larta të popullit dhe punën e gjallë të tij, traditat luftarake e atdhetare të tij, populli i ka bërë të vetat duke shkrirë autorësinë e tij dhe duke i shëndrruar në këngë popullore. Kjo ka ndodhur edhe me

krijimet e kompozitorit Muharrem Xhediku dhe ky është një fat dhe nder për të.”

Aktori Sulejman Dibra në kumtesën e tij nënvizoi se Xhediku ashtu siç ishte i pastër dhe elegant në trupin e tij ashtu ishte i pastër, elegant, me taban popullor, me ide të reja përparimtare, me forcë emocionale dhe shprehëse edhe në krijimet e tij muzikore që kanë lënë gjurmë në muzikën tonë kombëtare, megjithse Muharremi jetoi aq pak. Kontributi i Xhedikut në Teatrin Popullor, në Filarmoninë Shqiptare, në krijimtarinë popullore, në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë ka qenë shumë i çmuar.

Studiuesi dhe kritiku Mexhit Prençi në mes të tjerave në kumtesën e tij theksoi se veprat e Xhedikut janë tokë e palëruar, prandaj na del për detyrë që të gjurmojmë dhe të studiojmë më shumë për veprën e tij sepse ka vlera kombëtare.

Bashkim Mërtiri e vuri theksin tek vlerat e Xhedikut në fushën arsimimit dhe dukimit të brezave. Xhediku theksoi ai ishte njeri me kulturë të gjërë, njohës i disa gjuhëve të huaj, muzikant i shkolluar në shkolla të përmendura të Europës prandaj edhe dha kontribut edhe në fushën e arsimit. Gjatë jetës së tij 42 vjeçare ai krijoi vepra me vlera në fushën e muzikës që do tu mbeten brezave.

Artsiti i Merituar Hazis Ndreu vlerësoi krijimtarinë muzikore dhe letrare të Xhedikut të pandarë nga njëra tjetra, sepse Xhediku në më të shumtat e rasteve i bënte vetë tekstet e këngëve dhe të operetave të tij. Kjo e shtonte edhe më shumë vlerën e veprave të tij.

Xhelal Çerpja, drejtor i shtëpisë së kulturës Zall Dardhë, në fjalën e tij tha se arësyeja që vepra e Xhedikut rron dhe do të rrojë edhe në të ardhmen, pas vdekjes së autorit është origjina e tyre burimore popullore. Megjithse u largua nga jeta në moshë të re, në kulmin e krijimtarisë së tij, Xhediku mbetet një nga pionerët e muzikës së lehtë shqiptare.

Shtëpisë së kulturës Zall Dardhë ju dha emri i Muharrem Xhedikut.

Një përvjetor i paharruar

(Mbresa nga 65 vjetori i ditëlindjes së Kompozitorit Muharrem Xhediku, organizuar në vendlindjen e tij në Zall Dardhë të Dibrës)

Nga Kujtim Çerpja

Në verën e vitit 1982 sapo kisha përfunduar stazhin e punës pas kryerjes së shkollës së mesme në Krujë, shkova me pushime në fshatin tim të lindjes në Zall Dardhë.

Ishte mengjez i datës 26 qershor. Për ne amatorët, interpretuesit dhe dashamirësit e muzikës popullore, po të ndodhesh në qendrën e Zall Dardhës ndalesën e parë do ta bëje në shtëpinë e kulturës, e cila në çdo kohë ishte e banuar me banorët artistë dhe artdasheës, që për Zall Dardhën nuk kanë qenë të pakët.

Edhe unë si një ish interpretues dhe ish banorë i saj pa mëdyshje që aty do të gjëndesha.

U futa në këtë shtëpi, në këtë institucion artistik me emër të madh në kohëra, si gjithmonë me një mal emocionesh të forta në kujtim të aktiviteteve artistike të kryera në moshën më të re të jetës sime duke filluar që në klasën e tretë. Vazhdoj të përshkoj korridorin për tek dhoma e muzikës, ku tingujt melodioz të fizarmonikës së Qemalit më tërheqin me vrap. Qemal Toluli artisti i fizarmonikës po interpretonte "Cuca e Radomirës".

U futa në dhomë duke interpretuar dhe duke vazhduar këngën.

U përqaftua shumë përzemësisht me Qemalin duke e vazhduar këngën.

Pas shumë pyetjesh për shëndetin, familjen, shkollën etj, Qemali më drejtohet me shumë interes duke më pyetur: "A e din ti kush e ka kompozuar këngën e 'Te kroni' ? Po këngën 'Cucë e Radomirës' ?

Këtë e di mirë, ju përgjigja se është kompozitori ynë, Muharrem Xhediku, bile edhe kengen “Gersheti i luftrave” ose “Tek Burimi” siç e njohim ne, ai e ka kompozuar.

E po i dashur Kujtim, je me fat që ke ardhur në këtë ditë kaq të shënuar dhe të bukur për ne Derjanët, është 65 vjetori i Muharrem Xhedikut, muzikantit nga fshati ynë. Dhe ti futu direkt në prova sepse do të këndosh një këngë të Xhedikut dhe meqenëse je edhe I veshur me kostum popullor do të këndosh Cucën e Radomirës

Ndërkohë erdhi edhe përgjegjësi ë shtëpisë së kulturës Xhelal Çerpja, duke folur me zë të lartë siç e kishte zakon, me pyetjen e tij të zakonshme po ky nga erdhi, nga na mbiu ?

Filluan përgatitjet. Qendra e Zall- Dardhës po mbushej plot me njerëz , vinin artistë dhe amator të muzikës nga të gjitha anët, jo vetëm nga Dardha por edhe nga krahinat për rreth si Reçi, Lura, Çidhna, Sllova etj, një festë e pa parë ndonjëherë në Zall Dardhë.

Ky vend që kishte nxjerrë me dhjetra artistë për gjatë shumë viteve, për herë të parë organizonte një ngjarje të tillë për të nderuar në pedestal figurën e një artisti të madh të vendit të vet.

Programi i koncertit ishte hartuar me shumë kujdes. Këngë, kumtesa, kujtime të artistëve, të bashkëmoshatarëve, interpretim në skenë të këngëve të kompozitorit, të shoqëruar me duartrokitje e brohoritje të papara në sallë. Ne thonim me njëri tjetrin... ja që erdhi dita, i lumtë shtëpisë së kulturës, i lumtë Xhelalit.

Për mua kjo ditë qe jo vetëm një aktivitet i bukur, sepse në shtëpinë e kulturës Zall Dardhë gjithmonë aktivitete të bukura organizoheshin, por qe dhe një vlerësim i madh për vendlindjen, për skenën që më kishte munguar për katër vite.

Ishte një emocion ë madh të interpretosh një kompozitor kaq multidimensional, i panjohur mirë deri në këto ditë.

Ishte me të vërtetë emocion për të gjithë kumtesa e mbajtur nga Çesk Zadeja për ish kolegun dhe bashkëkohësin e tij e jo vetëm si ish shok, por si një ndër kolosët e parë të muzikes shqiptëre në vitet e para të pasluftës.

“E kam njohur djalin tuaj që në moshë të rinisë, kam punuar me të, ka bërë kompozime shumë të bukura. Ju njihni më shumë Cucë e Radomirës”, është shumë e bukur, por për mua më e bukura është “Gërsheti i luftrave”, ajo, është kënga që na ka bashkuar...”

Në këtë cast salla ishte e papërmbajtëshme dhe shpërtheu në duartrokitje të fuqishme që zgjatën jo pak. Pas fjalës së Zadesë, pas vlerësimit për këngën “Cucë e Radomirës”, prezantuesi i koncertit ka prezantuar këndimin e kësaj kënge jashtë radhe. Imagjinoni sa emocion ishte të interpretoje pas fjalës së një artisti të madh si Çesk Zadeja dhe vlerësimit të tij për Xhedikun. Muzikantë dhe njerëz të mëdhenj si Xhediku janë të rrallë.

Kujtim Çerpja

Kryetar i Shoqatës “Valët e Drinit”

DY FJALË PËR MUZIKANTIN MUHARREM XHEDIKU

Ndodh shpesh që takon njerëz të apasionuar që dëshirojnë të bëjnë diçka në fushën e letërsisë dhe artit dhe pasioni dashje pa dashje i rrëmben dhe i bën pjesë të kohës kur punoi e jetoi personazhi apo heroi i tyre. Kështu ka ndodhur me autorët Halil Rama dhe Sakip Cami me monografinë kushtuar kompozitorit Muharrem Xhediku. Ata më flisnin me pasion për këngët, tekstet dhe muzikën e Xhedikut, jo sikur të kishin kaluar 50 vjet nga vdekja e kompozitorit, por sikur të ishte gjallë dhe në krijimtari produktive. “Amaneti” i Xhedikut është transmetuar mirë dhe bukur tek dashamirësit e muzikës shqiptare. Xhediku duket sikur thotë se ai bëri aq sa mundi në kohën e tij për muzikën shqiptare, krijoi këngë dhe muzikë të bukur që u mbeti brezave.

Autorët Halil Rama dhe Sakip Cami më dhuruan diskun e këngëve të Xhedikut të kënduara në vitet 60 dhe fotografitë e viteve 1944-1959 dhe më kërkuan mbresat e mija për këtë figurë shumëdimensionale të muzikës shqiptare.

Kompozitori Muharrem Xhediku i përket brezit të muzikantëve të pasluftës së dytë botërore që edukimin muzikor e morën në vitet 40 në shkollën përendimore. Pas çlirimit ai shkroi dhe kompozoi më shumë për dashurinë dhe jetën e bukur idealiste. Në këtë plejadë krijuesish së bashku me Xhedikun hynë kompozitorët Preng Jakova, Pjetër Dungu, Baki Kongoli, Abdulla Grimci, Gaqo Avrazi etj.

Në vitet 50-60 kur punoi dhe kompozoi Xhediku egzistonin dy tendenca kryesore në fushën e muzikës, ajo sentimentale e mësuar në shkollat përfundimtare dhe ajo e punës dhe profesioneve të punës siç ishin këngët për traktoristen, tekstilisten, brigadierin etj. Në vitet 50-60 të shekullit 20, kënga e muzikës së lehtë njohu një zhvillim të dukshëm sidomos në qytetet kryesore si në Tiranë, Shkodër, Durrës, Korçë, etj . Ajo u bë një nevojë shpirtërore e rinisë dhe e shoqërisë në tërësi duke mbushur boshllëkun kulturor. Muzika e vallzimit u bë pjesë e repertorit të muzikantëve, ndërmjet të cilëve spikati Xhediku. Në këto vite në shumë shtëpi kulture u hapën kurse për mësimin e veglave muzikore si violinës, kitarës, fizarmonikës, xhezit, saksit, klarinetës, trompës etj. Peshën kryesore e mbajtën muzikantët e mësuar në Liceun artistik “Jordan Misja “ të krijuar që në vitin 1946. Mbrëmjet e vallzimit kanë qenë në modë në të gjitha gjimnazet e Tiranës si dhe këngët e muzikës së lehtë të kënduara dhe të kërcyera prej të rinjve dhe të kompozuar prej muzikantëve shqiptarë , ndërmjet tyre edhe Xhediku.

Në këtë klimë artistike u zgjeruan kërkesat për muzikën e lehtë dhe për muzikën e kultivuar popullore dhe u krijuan institucionet e para kulturore kombëtare. Filluan dhe shkëmbimet kulturore ndërmjet popujve dhe vendeve sidomos vendeve të demokracive popullore ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Në këtë kuadër shkëmbimesh kulturore dhe arsimore u shkolluan në Moskë, Pragë, Budapest, Varshavë, Berlin dhe Petërburg shumë kuadro të muzikës dhe artit shqiptar. Këto kuadro u kthyen në Shqipëri pas vitit 1954 dhe deri në këtë periudhë peshën kryesore e kishin mbajtur artistët e përgatitur në Itali dhe Austri si Xhediku, Kongoli etj. Vetëm Ansambli i ushtrisë nën drejtimin e Gaqo Avrazit ishte institucioni i parë kulturor që funksiononte në vitet 50. Më pas u krijuan Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve , Teatri Popullor (Kombëtar), Teatri i Operas dhe Baletit.

Duke kujtuar kompozitorin Muharrem Xhediku në këtë kohë kujtojmë edhe këngëtarët e brezit të tij që kënduan këngët e tij si Pjetër Gjergji me zërin e tij të ëmbël dhe të butë, Anita Taken e Pavlina Nikajn, të përherëshme në shfaqjet e Estradës së Tiranës, Rudolf Stambollën, Zan Zyberin dhe Xhavit Xhepën, duetin Gjergji etj.

Po ndalemi pak më shumë tek kënga simbol e atyre viteve “Të lutem falmi sytë e shkru” . Është kënga që shpreh në maksimum muzikalitetin, tekstin e bukur të dashurisë, magjinë e tingullit, dhe brengën e të riut të dashuruar. Kush arrinte që në këtë tango të merrte në vallzim vajzën që dashuronte ai nuk kishte nevojë tu lutej syve të shkru të vajzës sepse atë tashmë e kishte në krahët e tij duke kërcyer bukurinë shqiptare për të cilën aq shumë është

shkruar dhe do të shkruhet. Imagjinoni prushin e dashurisë në duart e të rinjve gjatë vallzimit të tangos, apo këngëve të muzikës së lehtë të Xhedikut. Është sublime, hyjnore dhe e paaritëshme frymë dhe aroma e dashurisë në këto këngë, tango shqiptare të kompozuar nga Muharrem Xhediku. Dhe këtë e dinë dhe e njohin vetëm ai brez që i këndoi dhe e kërceu muzikën e tij. Ja pra, përse muzika është kaq e magjishme, sepse merret me kombinimin e tingujve. Dhe këtë kombinim dinë ta bëjnë mjeshtra të mëdhenj si Muharrem Xhediku që do të mbetet në fondin e artë të muzikës së lehtë shqiptare dhe në atë të kultivuar. Xhediku është dhe mbetet një krijues original që njeh melosin popullor dibran, por edhe melosin mbarëshqiptar, që mbështetet fort tek tabani kombëtar. Tek tradita patriotike, epizmi, lirizmi dhe jeta e gjallë e njerëzve mbështetet krijimtaria e tij. Ai mbeti liriku më i spikatur i muzikës së kultivuar dibrane, por edhe shqiptare.

Rivlerësimi i krijimtarisë muzikore të tij është një detyrë që i bën nder kulturës muzikore shqiptare, sepse Xhediku është ndër ata kompozitorë që hodhën themelet e muzikës shqiptare, veçanërisht të muzikës së lehtë, apo të tangos shqiptare.

Autorët e kësaj monografie kanë meritën e ringritjes së vlerave të këtij kompozitori të harruar që nuk la as trashëgimtarë në familjen e tij, por na la trashëgim veprën e tij muzikore të pavdekëshme që tashmë e kemi në duar, të ripërtërirë.

Shaqir Rexhvelaj

KONTRIBUTI I XHEDIKUT NË ORKESTRËN E FILARMONISË SHQIPTARE DHE NË ANSAMBLIN E KENGEVE DHE VALLEVE POPULLORE

Nga Prof Asoc. Dr. Nexhat Agolli

(bashkëkohës i kompozitorit)

Muharremin e kam njohur në punë të përbashkët në Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Popullore të Shtetit. Filarmonia e Shtetit që u krijuan në fillim përbënte bazën e muzikës dhe të orkestrës së vendit. Aty bënte pjesë Estrada dhe grupi i këngëve dhe valleve popullore. Këtu ra në sy puna e Muharrem Xhedikut si një muzikant i formuar. Në orkestër bënë pjesë instrumentet e violinës, kitarës, klarinetës, daulles, flautit, basit etj. Muharremi luante si kitarist, por ishte edhe drejtues orkestre. Nga kjo orkestër u përpunuan të gjitha këngët dhe vallet popullore, u hodhën në partitura dhe u vunë në skenë. Muharremi renditej në atë kohë përkrah kompozitorëve Baki Kongoli, Gaqo Avrazi, Agim Prodanit etj të cilët krijojnë pa u lodhur për plotësimin e nevojave të popullit për muzikë dhe për plotësimin e repertorit të kësaj filarmonie dhe të këtij ansambli.

Me Xhedikun nis një etapë e re në muzikën shqiptare, etapa e muzikës së lehtë. Këngët dhe pjesët orkestrale të Xhedikut ishin baza e kërcimit, (dansit), të asaj kohe. Netët e vitit të ri ishin të mbushura me këngët dhe orkestralet e Xhedikut. Ai së bashku me Prodanin janë themeluesit e tangos shqiptare. Këngët “Falmi sytë e shkru”, “Jelica”, “Ëngjëllushes” etj u bënë këngët që vërshëlleshin edhe nëpër rrugë nga rinia shqiptare. Ato mbartnin edhe frymën popullore dhe tabanin kombëtar. Ato janë kënduar nga Anita Take, Pavlina Nikaj, Pjetër Gjergji, etj.

Muharremi ishte jo vetëm një muzikant i talentuar, por edhe një njeri i mirë, i dashur dhe i sjellshëm me shokët dhe kolegët. Ai e dashuronte muzikën. Këngët e tij shpesh herë e humbën autorësinë, sepse Xhediku nuk punonte dhe nuk punoi për emër, për lavdinë e tij, por për lavdinë e muzikës shqiptare. Ai ishte shumë i kënaqur kur arrihej të plotësohej repertori i kërkuar edhe pse shpesh nuk e thoshte emrin e tij si krijues. Kështu ndodhi me këngët dhe vallet popullore që përpunoi, me orkestralet dhe pjesët muzikore të libreteve të estradës.

Kjo e bën veprën e tij muzikore të pavdekëshme, ndonëse të shkrirë me krijimtarinë e popullit, për të cilin ai krijoi deri sa vdiq.

KONTRIBUTI I MUHARREM XHEDIKUT NË ESTRADËN E TIRANËS

Nga Sulejman Dibra *

Ish Drejtor i Estradës Profesioniste të Tiranës në vitet 80

Një nga të parët që punoi pa u lodhur për forcimin e të parit teatër të estradës profesioniste, atë të Tiranës, është edhe Muharrem Xhediku.

Ndonëse jeta e tij që e shkurtër, vepra e tij artistike ishte e pasur, e gjërë dhe e larmishme. Ajo mbështetet plotësisht në tabanin tonë kombëtar. Si artist i shkolluar, ndonëse nuk arriti ti përfundonte studimet për arsye ekonomike, ai u shqua si kompozitor i talentuar, si dirigjent orkestre dhe si kitarist i shkëlqyer. Pra ai ishte në të njëjtën kohë tridimensional në muzikë.

Veprimtaria e Xhedikut nuk i ka fillimet në estradë. Ajo i ka fillesat qysh në vitet 43 në Prishtinë, ku së bashku me Eftim Dherin, Emil Milotin dhe shokë të tjerë orkestrantë e këngëtarë ushtrojnë aktivitetet në Radio Prishtinën, ku janë inçizuar disa këngë e valle popullore kosovare, të përpunuar nga Xhediku.

Pas çlirimit të vendit, hapet një faqe e re për ta zhvilluar talentin e tij. Kontributi i tij është kryesisht në lëvrimin e këngëve të muzikës së lehtë dhe në përpunimin e këngëve dhe valleve popullore. Në vitet e para me krijimin e filarmonisë shqiptare Muharremi ndodhet përkrah artistëve të mirënjohur Kristaq Antoniu, Konstandin Trako, Gaço Avrazi, Mustafa Krantja, Marie Kraja, etj. Pranë filarmonisë shqiptare Muharremi u muar dhe krijoi formacionin e parë orkestral dhe me kompozimin e disa këngëve të muzikës së lehtë dhe asaj popullore. Vlen të përmendet vallja me përmasa të mëdha e vënë në skenë nga Panajot Kanaçi me titull :”Vallja e popujve” e mbështetur në motivet popullore të Xhedikut.

Xhediku nuk njihete vetëm këngët dhe valet popullore të Dibrës nga vinte, por edhe të Tiranës ku ishte rritur, edhe të Kosovës, ku kishte punuar, me një fjalë Xhediku ishte një muzikant me përmasa kombëtare ku çdo krahinë gjente vetvehten në krijimtarinë e tij. Folklori popullor ishte burimi i frymëzimit të tij. Në krijimet e tij do të gjeje lirizmin e bukurisë së malsores, epizmin e këngëve dhe valleve tona kreshnike, dhe padyshim përfshihesh natyrshën në botën muzikore të autorit.

Në Estradën e Tiranës ai ishte me detyrën e kompozitorit dhe të dirigjentit të orkestrës. Në punë atë e karakterizonte disiplina e punës dhe disiplina artistike, tingëllimi unik dhe i pastër i formacionit muzikor që drejtonte. Përveç kompozimit ai bënte vetë edhe orkestrimin e këngëve dhe pjesëve muzikore duke kërkuar në maksimum tingull unik. Gjatë kohës së punës në estradë ai krijoi shumë këngë të muzikës së lehtë, muzikës së vallzimit dhe në një farë mënyre dhe mase ai njihet si themeluesi i këngës së muzikës së lehtë

shqiptare. Kompozoi me rradhë këngët që mbetën të pavdekëshme në fonotekën e muzikës shqiptare si “Falmi sytë e shkru”, “Te burimi”, “Matura”, “Këngë për fshatin tim” etj.

Kënga “Kufitari” ishte një nga këngët e bukura të Xhedikut që u këndua gjatë në atë kohë dhe që u kushtojë ushtarëve kufitarë që vigjilonin si shqiponja në mbrojtje të atdheut duke sakrifikuar edhe dashurinë e tyre , edhe rininë e tyre.

I thjeshtë, elegant, i pastër, i veshur bukur, pa fjalë, i buzëqeshur. Ky ishte portreti i këtij muzikanti të talentuar.

Për estradën ai krijoi edhe parodi e kuplete. Në atë kohë u vunë në skenë premierat me titull “Qesh e ngjesh” , “Ta themi troç”, “Pak nga të gjitha”, “Mizën buall” “Poshtë e lart” etj. Me muzikën e Xhedikut u vu në skenë komedia e Dionis Bubanit “Mirëmëngjes shoku Sokrat” ku interpretun Margarita Xhepa, Enver Dauti etj. Në Radio Tiranën ishte një orë gazmore me dy personazhe Cani dhe Ishja, ku interpretoheshin kupletet e kompozuaranga Xhediku.

Vija melodike e muzikës së Xhedikut ishte shumë e thjeshtë dhe pëlqyeshme nga publiku. Edhe në diskutimet profesionale si në estradë, ashtu edhe në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve, vihej re këmbëngulja për të krijuar muzikë të bukur që të pëlqejë nga publiku.

Ai punonte shumë me këngëtarët, për të realizuar një interpretim të saktë dhe të arrirë, duke i kushtuar vëmëndje dhe kujdes zbulimit të talenteve të reja. Në saj të punës së palodhur të Xhedikut kemi afirmimin e suksesshëm të shumë këngëtarëve të njohur të asaj kohe si Fitnete Rexha ,Pjetër Gjergji, Anita Take, Hajrie Harapi, Xhavit Xhepa etj.

Edhe kur i shtruar në spital, në sanatorium, kmpozonte këngë të reja me kitarën e tij dhe na i dërgonte në estradë. Disa këngëtarë i thirrte atje dhe ua mësonte këngët.

Muzikantë të tillë të talentuar dhe pasionantë si Muharrem Xhediku janë të rrallë.

- Ky material është përgatitur nga një grup pune dhe në bashkëbisedim me të gjithë ta që kanë punuar me Xhedikun në Estradën e Tiranës dhe është mbajtur nga Z. Sulejman Dibra, ish drejtor i Estradës së Tiranës, në Simpoziumin shkencor kushtuar 65 vjetorit të tij.

Vlerat artistike të teksteve të këngëve të Xhedikut dhe harmonizimi i teksteve me muzikën

Nga Azis Ndreu

(Artist i Merituar)

Krijimtaria letrare dhe ajo muzikore në një vepër arti janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura nga njëra tjetra. Bazë e frymëzimit muzikor është pa dyshim teksti letrar. Kompozitori zakonisht frymëzohet nga një tekst i mirë dhe krijon muzikën në përputhje me këtë tekst. Kjo ka ndodhur edhe me Xhedikun. Ai ka bashkëpunuar me shkrimtarë e poetë me emër si Spiro Çomora, Fadil Kraja etj, por ai, në më të shumtat e rasteve i ka krijuar vetë tekstet dhe jo sikurse ka ndodhur me disa këngë që nuk ngjisin dhe nuk kordinojnë tekst muzikë sepse në fillim është krijuar muzika, pastaj teksti dhe është bërë arnimi dhe jo një krijim unik artistik.

Prandaj në këngët e Xhedikut, në saj të këtij kordinimi dhe shkrimi nga vetë kompozitori edhe të tekstit, edhe të muzikës, kënga vjen natyrshëm me një vijë melodike që të kënaq shpirtin dhe pa asnjë pengesë. Këngë si “Falmi sytë e shkru” “Vajzë ëngjëllore” etj, janë shkruar me ndjenjë dhe me lirizëm të hollë sa që nuk besoj që të ndryshohen më.

Tekset e Xhedikut janë kryesisht tekste lirike, që u kushtohen vashave dhe djemve si yje. Edhe në këngët e Luftës nacionalçlirimtare përsëri vihet re lirizmi si p.sh. tek kënga “Djaloshi zbriti”. Lirizmi, ngrohtësia dhe sinqeriteti janë karakteristikat e teksteve të Xhedikut , që i shoqëron muzika e ëmbël e tij.

Tematika e këngëve të Xhedikut është e larmishme. Ajo përfaqon edhe temën e emancipimit të vajzës dhe të gruas shqiptare, si p.sh “Do ta gris çarçfin” etj. Këtë emancipim ai e kupton me daljen e saj jashtë mureve të shtëpisë dhe pjesëmarrjen e saj në veprat e punës dhe të dritës.

Vlerat artistike të teksteve të këngëve të Xhedikut dhe harmonizimi i teksteve me muzikën janë baza e suksesit të tij.

Kënga “Falmi sytë e shkruar” e M. Xhedikut

ndërmjet 100 këngëve të shekullit

Siç e keni ndjekur Televizioni kombëtar “Klan”, nën drejtimin e kompozitorit Adrian Hila, regjizorit Bledar Laço dhe drejtuesit Pandi Laço organizuan

konkurimin e 100 këngëve të shekullit, ku u ndërthur bukur tradita me novatoren, e kaluara me të sotmen muzikore. Larg nostalgjisë publiku artdashës shqiptar vlerësoi këngët më të mira të shekullit të 20-të. Midis dhjetra kompozitorëve të talentuar, midis dhjetra këngëve të mrekullueshme, me riorkestrimin e kompozitorit të mirënjohur Edmond Zhulali dhe nën interpretimin e Aleksandër Gjokës u paraqit edhe kënga “Falmi sytë e shkruar”, e cila befasoi për muzikalitetin e saj dhe tekstin e saj të ndjerë për dashurinë.

Edhe sot e gjithë ditën kënga pëlqehet, këndohet e fishkëllehët nga të rinjtë dhe nga publikë muzikëdashës, gjë që flet për muzikalitetin e krijimeve të Xhedikut dhe të aftësisë së tij krijuese.

Anita Take (Prodani)

Muharrem Xhediku ka qenë një kompozitor i talentuar, por fatkeqësisht vdiq shpejt



Anita Take është ngjitur në skenë para 50-vjetësh, por akoma vazhdon të kujtohet me nostalgji nga të gjithë ata që e kanë njohur atë. Ajo akoma ka mbetur në kujtesën e shqiptarëve dhe shumë këngë të saj akoma këndohen edhe sot. Kjo tregon se këngëtarja e madhe Anita Take me ëmbëlsinë e zërit dhe interpretimin e shkëlqyer në skenë, ka lënë gjurmë të thella në historikun e muzikës dhe të këngës shqiptare.

Jeta e saj në skenë përmbledh një epokë 50-vjeçare.

Të ka rastisur të dëgjosh ndonjë nga këngët e tua dhe si të është dukur interpretimi nga këngëtarët e tjerë?

Ka pasur shumë raste, kur unë kam dëgjuar këngët e mia të kënduar nga këngëtarë të tjerë. Kjo nuk më kanë lënë ndonjë shije të veçantë, përveçse kënaqësisë që kënga ime jeton. Unë gëzohem jashtëzakonisht shumë, kur

dëgjoj këngët e mia të këndohen nga të tjerët dhe nuk rrëmbehem nga i mendimi, që ata i kënduan, i kënduan më mirë, ose më keq se unë. Për mua nuk ka rëndësi kush i këndon, por ka rëndësi të jetojë kënga dhe ajo të përcillet ndër breza. Kjo mendoj unë është arritja më e madhe për një këngëtar, apo krijues. Këtu unë nuk kam parasysh çmimet e marra nëpër festivale, por çmimin e madh që të jep publiku, duke i duartrokitur dhe i kujtuar ato këngë. Pra, unë mendoj se këngësinë më të madhe nuk ta japin çmimet, por ta jep publiku dhe jetëgjatësia e këngës, duke u transmetuar brez pas brezi. Kam qenë shumë e re kur jam ngjitur në skenë. Ka qenë viti 1949. Në atë kohë, kam qenë si amatore në Shtëpinë e Oficerave, pasi atëherë nuk kishte festivale, nuk kishte as skena, ku ne mund të dilnim lirshëm, siç dalin sot këngëtarët, nuk kishte as televizione për të shpalosur talentin tone. Në kohën kur unë nisa rrugën e këngës, kishte pak këngëtarë dhe kompozitorë në Shqipëri. Në atë kohë ishte një bërthamë e vogël këngëtarësh dhe kompozitorësh, që kishin studiuar jashtë Shqipërisë, si në Austri dhe në Itali. Unë i përkas atij brezi, që dolëm si luledalet, që dalin pas një shiu në pranverë. Ashtu filluam të dalim edhe ne katër, apo pesë këngëtarë, ku më pas vitet bënë që të dalin qindra e qindra këngëtarë, të cilët debutuan dhe vazhdojnë të debutojnë me shumë dinjtet brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Si kanë qenë marrëdhëniet e Anita Takes me kolegët dhe, a takoheni tani shpesh për të kujtuar dhe hequr mallin e atyre viteve?

Marrëdhëniet e mia me kolegët kanë qenë shumë të mira, madje do të thoja më shumë se të mira. Në atë kohë, duke qenë se ishim shumë pak këngëtarë dhe krijues, qëndronim shumë më afër njëri-tjetrit. Unë kam pasur partnere dhe partnerë në skenë, me të cilët ruaj kujtime shumë të bukura. Pjesa më e madhe e tyre nuk jetojnë më, por unë i kujtoj akoma me respekt. Kujtoj me respekt edhe ata që jetojnë dhe kur mblidhemi nëpër festa të ndryshme, kujtojmë me shumë nostalgji periudhën që kemi kaluar bashkë, si dhe arritjet dhe zhgënjimet në fushën e muzikës.

A keni punuar me kompozitorin Muharrem Xhediku dhe çfarë përshtypje keni nga ky bashkëpunim ?

Kam punuar me Muharrem Xhedikun që në fillimet e para të Radio Tiranës, të filarmonisë shqiptare dhe të Estradës. Ai ishte një muzikant i talentuar si instrumentist, si kompozitor edhe si drejtues. Ai ishte i sëmurë me tuberkuloz dhe pjesën më të madhe të kohës e kaloi në spital. Erdhi nga lufta me këtë sëmundje të rëndë të cilën nuk e përballoi dot. Unë kam kënduar disa këngë të M.Xhedikut si “Te burimi”, “Vajzë ëngjëllore” etj. Pavlina Nikaj ka kënduar gjithashtu shumë këngë të Xhedikut. Këngën “Falmi sytë e shkruar” e ka kënduar për herë të parë Pjetër Gjergji. Edhe sot dëgjoj këngët e Xhedikut dhe

më vjen keq ndonjëherë kur nuk thuhet se është këngë e tij, por humbet autorësia. Disa riorkestrime të fundit të këngëve të tij janë të bukura.

Muharrem Xhediku ishte një muzikant i mrekullueshëm. Më vjen mirë që po shkruani për të këtë monografi.

Skënder Cala

Aktor , regjizor dhe këngëtar profesionist në Teatrin e Estradës së Peshkopisë

Zall Dardha e lindi, Shqipëria i dha frymëzim, muzika e bëri të pavdekshëm

Në fillim të viteve 50, dëgjoja zërin engrohtë të babait tim, Selmanit, që këndonte nën zë disa këngë të bukura që më mbetën në mendje. Veçanërisht, kënga e anëve tona “Cuca e Radomirës” ishte e preferuara e tij. Edhe mësuesit mi të shkollës më vinin shpesh që ta këndoja këtë këngë. Ndoshta kjo që edhe nisma e parë e imja për tju kushtua artit dhe muzikës.

Ne ishim vendosur herët në Tiranë në vitet 20 dhe babai thoshte shpesh:”Kemi edhe një dernjan (Zall Dardhas) të mirë që mbron jo vetëm Dardhën por edhe të gjithë Dibrën.” E pra ky ishte Muharrem Xhediku. Me babain tim kishin të përbashkët historinë e tyre të jetës së vështirë prej jetimi. Edhe babin tim e kishte marrë nën mbrojtje dhe kujdes një bijë e madhe e fisit të Xhedikëve, Mihane Xhediku (Cala), e shoqja e Hazis Calës, xhaxhait të babait, të cilët nuk e ndanë bSelmanin nga fëmijët e tyre Jahen, Mersimin, Xhemilen dhe Nurijen deri kur përcollën për ushtar.

Ishin këto arsye që njohjet dhe lidhjet me Muharrem Xhedikun, jo vetëm i ruajti, por edhe i zhvilloi. Këto lidhje u trashëguan edhe tek unë. Unë kam patur në repertorin tim si këngëtar këngët e bukura të M.Xhedikut “Baresha e malit”, “Vashës time” etj. Unë u shkollova për aktor dhe regjizor, por hobi im mbeti kënga dhe ndoshta këngët e Xhedikut qenë piknisja imja si këngëtar dhe rruga e gjatë e mëvonëshme e këngës. Muharremi vdiq shpejt dhe këngët e tij u burgosën sepse artistëve servilë dhe mëdiokër u interesonte që të mos njihej dhe përhapej vepra e tij artistike.

Në vitin 1982, me rastin e 65 vjetorit të ditëlindjes së këtij muzikanti të talentuar organizuam në vendlindjen e tij në Zall Dardhë, një simpozium shkencor kushtuar njohjes së veprës së tij. Vepra e Xhedikut sot është pothuajse e panjohur. Ajo vlen të njihet sepse ai është një nga themeluesit e

muzikës së lehtë shqiptare dhe një nga kultivuesit e këngës dhe valles popullore.

Përveç botimit të kësaj monografie duhet ti propozohet edhe Presidentit të Republikës për nderimin e veprës së tij.

Xhediku vdiq shpejt, në moshën 42 vjeçare, në kulmin e krijimtarisë së tij. Edhe pse kanë kaluar dekada pas vdekjes së tij, ne përulemi me veneration para kitarës dhe veprës së tij muzikore.

Caje Poleshi,

këngëtare e muzikës popullore

Zall Dardhë

Xhedikun e kemi patur udhërrëfyesin tonë në rrugën artistike

Kur u bëra këngëtare në Grupi Artistik të zonës dhe në Estradën Profesionaliste të Peshkopisë mësova më shumë për jetën dhe veprën e kompozitorit Muharrem Xhediku. Ne krenoheshim me këtë njeri, me këtë kompozitor që kishte kompozuar këngë të bukura dibrane dhe këngë të muzikës së lehtë. E kishin krenarinë tonë dhe udhërrëfyesin tonë në rrugën artistike. Pjesët e tij muzikore dhe këngët e tij i kishim në repertorin tonë.

Edmond Zhulali, kompozitor

Jam krenar që kam punuar në Dibrën e Muharrem Xhedikut,

kësaj treve të pafund të krijimtarisë popullore

Aleksandër Gjoka

Këngëtar

Kam ndjerë kënaqësi të veçantë kur kam interpretuar

këngën “Falmi sytë e shkruar” të M.Xhedikut.

Unë jam një këngëtar që i përkas një plejade të re artistësh dhe nuk e kam njohur M.Xhedikun, por me këngën e tij më njohu dhe më bëri të ndjej kënaqësi kompozitori Edmond Zhulali që riorkestroi këtë këngë dhe e paraqiti në konkurimin e 100 këngëve të shekullit.

Që në fillim e ndjeja muzikalitetin e saj të veçantë, tekstin e lirshëm poetik të dashurisë dhe u dashurova me këtë këngë.

Jam i gëzuar që e kam kënduar këtë këngë të këtij kompozitori të talentuar që i ka qënduar shekullit.

E ndjej se suksesi i kësaj kënge vazhdon. Kënga është futur në internet, në shumë radio e televizione. Në një farë kuptimi ka marrë dhenë, është bërë e dashur për të gjithë. Unë jam ndjerë mirë me këtë këngë, si të thuash në shtratin tim të këngëve, në zhanrin tim muzikal.

Edhe pa e njohur them se Xhediku ka qenë dhe mbetet një muzikant i madh.

Ardian Trebicka

Këngëtar i muzikës së lehtë (tenor)

Frymëzimi im për albumin tim të titulluar “Tango” ka qenë kolosi i muzikës së lehtë dhe i tangos shqiptare Muharrem Xhediku

(Nga intervista dhënë gazetares Genta Popa në emisionin “Pasdite në TCH”)

Në kulmin e punës për të përfunduar monografinë kushtuar kompozitorit të viteve 60 , Muharrem Xhediku, ndoqa një intervistë me këngëtarin Ardjan Trebicka. Meqenëse ky këngëtar është një nga këngëtarët e mi të preferuar e ndoqa me kujdes intervistën e tij.

Pyetjes së gazetares Genta Popa (Prodani) për albumin e tij të titulluar “Tango” ai ju përgjigj se frymëzimin për këtë album e kam marrë nga muzika e viteve 60-70 nga të mëdhenjtë e muzikës së lehtë shqiptare Xhediku dhe Prodani.

Faleminderit Ardian

Të them drejtën u ndjeva shumë i kënaqur dhe i plotësuar kur edhe nga goja e këtij këngëtarit të kohës së sotme, të shkolluar në Lice dhe në Akademinë e Arteve të Bukura, dëgjova se ai e kishte studiuar në shkollë Xhedikun dhe e kishte idhull të tij. Artisti i mirë nuk e ka problem të pohojë për artistin e mirë, në dallim me disa të tjerë që ja mohuan dhe ja fshehën veprën Xhedikut dhe na e bënë edhe më të vështirë punën tonë studimore për këtë diamant të muzikës shqiptare. Faleminderit Ardian dhe të gëzofte zemra !

Për shkrimin e kësaj monografie u shfrytëzuan këto materiale:

1. Dosja personale në Teatrin e Operas dhe Baletit
2. Arkivi i Teatrit të Operas dhe Baletit
3. Arkivi i Filarmonisë Shqiptare
4. Arkivi i Teatrit Popullor
5. Arkivi i Estradës së Shtetit (Tiranës)
6. Arkivi i Ansamblit të Ushtrisë
7. Arkivi i Institutit të Folklorit
8. Arkivi i Radio Tiranës
9. Fonoteka e vjetër e Radio Tiranës
10. Arkivi i Shtëpisë së Krijimtarisë Popullore
11. Arkivi i Radio Shkodrës
12. Arkivi i Radio Kukësit
13. Arkivi i Radio Prishtinës
14. Arkivi i Radio Korçës
15. Arkivi i Shtëpisë së Kulturës Dibër

16. Muzeu i Dibrës
17. Arkivi i Shtëpisë së Kulturës Zall Dardhë
18. Materialet e Simpoziumit të vitit 1982 në Zall Dardhë, kumtesat e Çesk Zadesë, Sulejman Dibrës, Mexhit Prençit, Hazis Ndreut, Bashkim Mërtirit, Xhelal Çerpes.
19. Kujtime të Çesk Zadejës, Zihni Sakos, Konstandin Trakos, Tish Daisë, Avni Mulës, Gaqo Avrazit, Mihal Popit, Rifat Teqes, Fadil Krajës, Spiro Çomorës, Miço Kallamatës, Simon Gjonit, Kolë Jakovës, Tonin Harapit, Baki Kongolit, Vangjo Novës, Mustafa Krantes, Alqi Karecos, Mentor Xhemalit, Hysen Pelinkut, Marie Krajës, Fitnete Rexhës, Engjell Tërshanës, Bik Ndojës, Beqir Laçit, Hamdi Dodës, Qemal Kërtushës, Rexhep Dodës, Skënder Calës, Jahe Calës, Qatip Calës, Pandi Peleshit, Spiro Kalemit, Gani Tuçepit, Islam Xhelilit, Musa Xhemalçes, Shefqet Ushtelencës, Met Hajrullait, Tomor Çelit, Fali Nezhës, Haki Alimehmetit, Ramazan Zyberit, Hafsa Zyberit, Xheladin Hysës, Hysni Kacës.
20. Materialet e shtypit të kohës